

Dardan Krivaqa
dënohet me burgim të
përjetshëm për vrasjen e
Marigona Osmanit | FAQE 7



Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

TËRHIQET EDHE 25 PËR QIND E POLICËVE TË KOSOVËS NGA NDËRTESAT KOMUNALE NË VERI

TJETËR TËRHEQJE E POLICËVE NGA VERIU, KURTI: PË E ZBATOJMË MARRËVESHJËN E BRATISLLAVËS | FAQE 4-5



Policia ka vazhduar tërheqjen nga objektet komunale në veri të Kosovës. Të premtën janë tërhequr edhe 25 për qind e policëve të Kosovës nga këto objekte, duke e çuar në 50 për qind numrin e përgjithshëm të policëve të tërhequr. Me këtë rast, kryeministri

Albin Kurti ka thënë se janë duke e zbatuar me përgjegjësi dhe seriozitet marrëveshjen e Bratisllavës. "Kjo vjen pas vlerësimit të gjendjes së sigurisë nga mbledhja që pardje mbajtën drejtues të Policisë së Kosovës me EULEX-in dhe KFOR-in. Pra,

siguria është e mirë, situata është e qetë dhe mund ta zvogëlojmë ca praninë e policisë sonë", ka thënë Kurti. Ndërsa presidentja Vjosa Osmani ka folur rreth mbajtjes së zgjedhjeve në veri. Ajo ka thënë se mbajtja e këtyre zgjedhjeve nuk ka të bëjë fare me referendum

**PDK-ja:
900 DITË TË
QEVERISË
KURTI KANË
PRODHUAR
VETËM
SKANDALE**



FAQE 5

**LDK-ja: QEVERIA
KURTI ÇDO DITË
PO MERR KARTONË
TË KUQ, HYRI
NË HISTORI PËR
SHKELJE TË
SHUMTA TË
KUSHTETUTËS | FAQE 5**



AKTUALE



**SHALA: SPECIALJA NUK PO U
BESON INSTITUCIONEVE QË KRERËT
E UÇK-SË TË MBROHEN NË LIRI | F. 3**

**LUSHTAKU VIZITON ÇLIRIMTARËT
NË HAGË | F. 3**

**VETERANI I UÇK-SË DHURON
20 MIJË KILOGRAMË MIELL
PËR FAMILJET NEVOJTARE
TË MALISHEVËS | F. 6**

**ORCA, AKSION PARA MINISTRISË SË
ARSIMIT: PUSHTETI PO TENTON T'I
KAPË AGJENCITË E PAVARURA | F. 6**

EKONOMI



**ATK-JA PROMOVON TË DHËNAT E
HAPURA, MURTEZAJ THOTË SE PO
RRITIN TRANSPRENCËN DHE
LLOGARIDHËNIEN | F. 8**

**NISIN HETIMET NDAJ DISA
NDËRMARRJEVE PËR RRRITJEN E
ÇMIMIT TË VAJIT VITIN E KALUAR | F. 8**

SPORT



**SONTE BETEJA KRYESORE E
KOSOVËS | F. 10**

RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
E-mail: renova@mt.net.mk
Fax: +389 44 487 200
Mbx: +377 44 501 289

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
030-500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Blinkeni akuzon Rusinë për sulm ndaj sistemit botëror të ushqimit

UASHINGTON, 4 GUSHT - Sekretari amerikan i Shtetit, Antony Blinken, gjatë mbledhjes së Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, ka akuzuar Moskën për "shantazh", pasi Rusia së fundi është tërhequr nga një nismë kyçe e eksportit të drithërave. Kryediplomati amerikan, që ka udhëhequr mbledhjen për pasiguritë ushqimore, u ka thënë 15 anëtarëve të Këshillit të Sigurimit se "uria nuk mund të shndërrohet në armë". Ai ka thënë se Rusia, me nisjen e pushtimit të Ukrainës vitin e kaluar, shkaktoi "sulm" ndaj sistemit botëror të ushqimit.



Blinkeni ka kritikuar Moskën për tërheqjen muajin e kaluar nga marrëveshja që mundësonte eksportimin e sigurt të drithërave ukrainase përmes

detit, në kohën kur lufta ndaj dy shteteve po vazhdon. Moska ka refuzuar që të zgjasë marrëveshjen, duke çuar në rritjen e çmimeve të drithërave,

që ka goditur më së rëndi shtetet e varfra. "Çdo anëtar i këtij këshilli, çdo anëtar i Kombeve të Bashkuara duhet t'i thotë mjaft Moskës, mjaft përdorët Detin e Zi si shantazh. Mjaft i trajtuar njerëzit më të cenueshëm në botë si levë. Mjaft me këtë luftë të pajustificuar", ka thënë Blinkeni.

Marrëveshja, e nënshkruar në korrik të vitit 2022 në mes të Ukrainës dhe Rusisë me ndërmjetësimin e Turqisë dhe OKB-së, synonte shmangien e rrezikut për urinë në botë, duke garantuar qasjen e drithërave ukrainase në tregjet botërore, pavarësisht luftës.

Moska ka kërkuar garanci dhe marrëveshje të re sa i përket eksporteve të veta, veçmas për komponentët e plehrave artificiale.

Gjatë takimit në OKB, Blinkeni ka njoftuar se Washingtoni do të japë 362 milionë dollarë për financimin e programeve për luftimin e pasigurive ushqimore dhe kequshqyerjes në disa shtete afrikane dhe Haiti.

Afër 345 milionë persona në 79 shtete vuajnë nga pasiguria akute ushqimore. Ndër shkaqet kryesore për urinë në botë, përveç konflikteve të armatosura, janë edhe efektet e ndryshimeve klimatike.

Trumpi deklarohet i pafajshëm ndaj akuzave për komplot për përmbysjen e humbjes në zgjedhje

UASHINGTON, 4 GUSHT - Donald Trump është deklaruar i pafajshëm ndaj akuzave federale se ka orkestruar një komplot për përmbysjen e humbjes së tij në zgjedhjet presidenciale të vitit 2020 në Shtetet e Bashkuara. Prokurori i Posaçëm, Jack Smith, i cili ka udhëhequr hetimin ndaj asaj që prokurorët amerikanë e quajnë përpjekje të paprecedente nga presidenti i atëhershëm për të minuar shtyllat e demokracisë amerikane, ka shikuar nga rreshti i parë i sallës së një gjykate në Uashington, në pasditen e së enjtes (sipas kohës lokale), teksa Trump ka thënë se ndihet i pafajshëm, duke qëndruar para gjyqtarit Moxila Upadhyaya. Paraqitja e Trumpit në gjyq, e cila ka zgjatur rreth gjysmë ore, më 3 gusht, ka ndodhur vetëm një kilometër larg ndërtesës së Kongresit të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, të cilën mbështetësit e tij e sulmuan më 6 janar të vitit 2021, në përpjekje për ta ndalur certifikimin e disfatës së tij zgjedhore nga legjislativi amerikan. Deklarimi i Trumpit si i pafajshëm në gjyq - hera e tretë që ai bën një gjë të tillë në katër muajt e fundit - ka nisur një betejë disamujore gjyqësore, e cila do të zhvillohet në kohën e fushatës për zgjedhjet presidenciale të vitit 2024. Trump është favorit për të siguruar nominimin nga Partia Republikane për ta sfiduar në zgjedhje presidentin aktual nga radhët e Partisë Demokratike, Joe Biden. Në një aktakuzë prej 45 faqesh, të publikuar të martën, Smith ka akuzuar Trumpin dhe aleatët e tij për mbështetje të pohimeve të rreme se zgjedhjet e vitit 2020 ishin manipuluar, duke u bërë

trysni zyrtarëve shtetërorë dhe federalë që të ndryshonin rezultatet dhe t'ia merrnin votat elektorale Bidenit. Trump, 77-vjeçar, akuzohet, ndër të tjera, për konspiracion për mashtrimin e ShBA-së, për privimin e qytetarëve nga e drejta e tyre për t'iu numëruar votat, dhe për pengimin e një procesi zyrtar. Akuzat më serioze parasheh dënim me burgim prej 20 vjetësh. Seanca e radhës në gjyq do të jetë më 28 gusht, para gjyqtarës Tanya Chutkan, ndonëse Upadhyaya ka thënë se Trumpi nuk është i obliguar të marrë pjesë. Chutkan synon të caktojë një datë për gjykimin e Trumpit atë ditë, ka thënë Upadhyaya. Seanca e 28 gushtit do të zhvillohet pesë ditë pas debatit të parë të planifikuar mes kandidatëve republikanë për president. Trump ende nuk ka thënë nëse do të marrë pjesë në të.

Trumpi e ka cilësuar aktakuzën, si dhe rastet e tjera penale ndaj tij, si "gjueti shtrigash" që ka për qëllim pengimin e fushatës së tij për kthim në Shtëpinë e Bardhë. Në një varg shkrimesh në media sociale, të martën, ai e ka akuzuar administratën e Bidenit për shënjimimin e tij për poenë politike. Ai është deklaruar më parë i pafajshëm ndaj akuzave federale se ka mbajtur dokumente të klasifikuara, pasi është larguar nga pushteti, ndërsa shteti i Nju-Jorkut e akuzon atë se ka falsifikuar dokumente në lidhje me blerjen e heshtjes së një aktoreje pornografike.

Trumpi mund të përballet edhe me akuzat të tjera - në Xhorxhia, prokuroria shtetërore po heton përpjekjet e tij për ta përmbysur rezultatit zgjedhor atje. Prokurorja nga zona e Atlantës,



Fani Willis, ka thënë se do të ngre padi gjatë mesit të gushtit.

"Më duhen më shumë akuzat për ta siguruar zgjedhjen", ka shkruar Trump në platformën e tij, "Truth Social", para paraqitjes në gjyq, të enjten.

Rreth gjysma e republikanëve kanë thënë se nuk do të votojnë për Trumpin, nëse ai do të dënohej për ndonjë krim, sipas një ankete të re të zhvilluar nga "Reuters" dhe Ipsos, duke theksuar rreziqet potenciale që telashet e tij ligjore përbëjnë për kandidaturën e tij. Por, e njëjta ankete, e realizuar pas aktakuzës së të martës, ka demonstruar, po ashtu, qëndrueshmërinë e tij në garën brenda partisë republikane.

Rezultatet e anketës kanë treguar se ai tani gëzon mbështetjen e 47 për qind të republikanëve, teksa ka dyfishuar epërsinë karshi të dytit në garë brenda partisë, guvernatorit të Floridës, Ron Desantis, i cili mbështetet nga 13 për qind e republikanëve. Tri të katërtat e republikanëve kanë thënë se pajtohen se akuzat ndaj Trumpit janë "të motivuara

politikisht", gjë që tregon se pohimi i ish-presidentit amerikan, se është viktimë e përndjekjes politike, gëzon mbështetje të simpatizantët e tij. Shumica e madhe e udhëheqësve republikanë, përfshirë disa që po garojnë kundër Trumpit për të siguruar nominimin për Shtëpinë e Bardhë, ose e kanë mbrojtur atë, ose e kanë kritikuar atë butësisht, teksa kanë akuzuar administratën e presidentit Biden për shfrytëzim të Departamentit të Drejtësisë si armë kundër një kundërshtari zgjedhor. Shumë prej pretendimeve në aktakuzën e së martës kanë qenë të dokumentuara mirë në raportimet e mediave dhe në hetimin e kryer nga një komision i zgjedhur i Dhomës së Përfaqësuesve të Kongresit amerikan. Por, aktakuza ka përmbajtur disa detaje të panjohura më parë, përfshirë disa të bazuara në dëshmi para një jurie të madhe dhe shënime nga ish-nënpresidenti Mike Pence, i cili, po ashtu, po garon për të siguruar nominimin e republikanëve për president.

Aktakuza e përshkruan një bisedë telefonike, në të cilën Pence i ka thënë Trumpit se nuk kishte bazë ligjore për teorinë që Pence mund të bllokonte certifikimin e rezultatit zgjedhor të presidenciale të vitit 2020. "Je tepër i sinqertë", është përgjigjur Trump, sipas prokurorëve. Ndonëse Pence vazhdimisht i ka thënë Trumpit se i mungonte autoriteti për t'i hedhur poshtë votat elektorale nga shtete të caktuara, Trump ka vazhduar ta përsërisë qëndrimin e tij. Më 6 janar, teksa ka biseduar me mbështetësit e tij, para se ata ta sulmonin ndërtesën e Kongresit amerikan, Trump ka thënë: "Nëse Mike Pence bën gjënë e duhur, ne fitojmë zgjedhjet". Disa sulmues të ndërtesës së Kongresit më vonë do të brohoritnin: "Vareni Mike Pecen!".

Larg të qenët i shqetësuar nga dhuna, Trumpi dhe një bashkëpunëtor i paidentifikuar kanë vazhduar të thërrasin pjesëtarë republikanë të Kongresit, disa orë pas përfundimit të trazirave, ende të vendosur për bllokimin e certifikimit të rezultatit zgjedhor, thuhet në aktakuzë. "Kemi nevojë që ju, miqtë tanë republikanë, të përpiqeni ta frenoni", ka thënë bashkëpunëtori në një porosi me zë në telefonin e një senatori amerikan, sipas prokurorëve. Përshkrimi i bashkëpunëtorit në aktakuzë lë të kuptohet se bëhet fjalë për Rudy Giuliani, ish-avokatin personal të Trumpit, raporton "Reuters". Pence ka qenë njëri prej republikanëve të paktë që ka kritikuar Trumpin të martën, duke thënë se "kushdo që e vë veten mbi Kushtetutën kurrë nuk duhet të jetë president".

Papa Françesku paralajmëron vizitë në Kosovë

VATIKAN, 4 GUSHT - Papa Françesku synon që së shpejti të realizojë një vizitë në Kosovë. Kështu ka thënë vetë ai në një intervistë për revistën spanjolle "Vida Nueva". "Jemi duke punuar për vizitë në Kosovë, por asgjë nuk është vendosur", ka thënë Papa Françesku. Ai ka paralajmëruar vizitë në Argjentinë dhe Uruguai. Në

këtë intervistë, Papa Françesku ka zbuluar se ai po konsideron emërimin e një "përfaqësuesi të përhershëm" për të "shërbyer si urë" midis Rusisë dhe Ukrainës. Në të njëjtën kohë, ai ka njoftuar se i dërguari i tij special për të ndërmjetësuar në luftë do të udhëtojë në Pekin, duke pasur parasysh se tashmë ka vizituar

Kievin, Moskën dhe Uashingtonin. Pas udhëtimit që po bën aktualisht në Lisbonë, në kuadër të Ditës Botërore të Rinisë, Papa do të udhëtojë në Mongoli midis 31 gushtit dhe 4 shtatorit dhe do të marrë pjesë në Marsejë, Francë, në takimet mesdhetare, më 22 dhe 23 shtator.



Shala: Specialja nuk po u beson institucioneve që krerët e UÇK-së të mbrohen në liri

PRISHTINË, 4 GUSHT - Drejtori i Këshillit për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut (KMDLNj), Behxhet Shala, ka thënë se Gjykata Speciale, ndonëse e themeluar nga Kuvendi i Kosovës, nuk i përgjigjet këtij të fundit. Ndonëse e ka quajtur masë të skajshme, ai ka thënë se po ta kishin mundësinë juridike e ligjore, avokatët e të akuzuarve të kësaj gjykate do të mund t'i nxirrnin nga paraburgimi apo t'ua mundësonin të paktën një masë më të lehtë.

Një prej arsyeve pse kjo masë nuk është zëvendësuar është sepse, sipas tij, Gjykata Speciale nuk i beson Policisë së Kosovës për ta administruar procesin e arrestimit shtëpiak si masë. "Gjykata Speciale është një gjykatë tjetër e cila nuk i përgjigjet sistemit tonë, ndonëse publikisht gjithmonë deklarohet se është pjesë e drejtësisë së Kosovës, por nuk ka lidhje me të. As nuk i jep llogari Kosovës, as Kuvendit si themelues, as ministrisë, as askujt. Tash e ka një bazë joligjore që i mban ata në paraburgim. Sepse të gjithë ata që janë në paraburgim, ndaj disave prej të cilëve ka filluar gjykimi, kanë avokatë të zotë të cilët, po ta kishin një hapësirë ligjore, do të mund t'i nxirrnin nga paraburgimi ose t'ua zëvendësonin masën e paraburgimit me një masë më të lehtë", ka thënë Shala për "EO". Ai ka thënë se mbajtja në paraburgim e ushtarëve të UÇK-së është mjet i skajshëm. "Është një kërkesë prej organizatave ndërkombëtare, por edhe prej nesh që paraburgimi të jetë një mjet i skajshëm. Kur nuk ka



asnjë mundësi tjetër të vendoset paraburgimi dhe zakonisht te paraburgimi të përdoren masat alternative siç janë arresti shtëpiak, lajmërimi në Polici, kufizimi i lëvizjes jashtë vendit ku jetojnë, ky është rast i cili është larg Kosovës dhe ata mendohet se nuk kanë kapacitete ta mbikëqyrin arrestin shtëpiak sikurse nuk i besojnë Policisë së Kosovës që këta mund ta administrojnë arrestin shtëpiak në qoftë se ata vendosin që dikë prej tyre t'ua vendosin arrestin shtëpiak", ka

thënë ai. Më tutje, Shala ka thënë se shpeshherë e sheh si tendencë të Speciales që të akuzuarit të dënohen, madje të mbahen sa më gjatë në burg. Këtë ai e ka mbështetur duke thënë se ekziston mosgatishmëri e institucioneve që të japin një garanci të mjaftueshme e të fuqishme. "Ka qenë më parë një kërkesë në të cilën për të dhënë garanci disa shtete dhe Kosova, që në qoftë se ata kthehen në Kosovë me një masë më të butë, e jo me arrest me burg, atëherë

Kosova, Policia e Kosovës, do ta administrojë masën e zëvendësuar të arrestit me burg. Ata i kanë dërguar disa pyetje, Ministria e Drejtësisë është përgjigjur, por këta nuk kanë besuar që Kosova ka kapacitete për të administruar një masë tjetër dhe nuk duan që thjesht të flasin, por është një tendencë që këta njerëz të dënohen, të mbahen sa më shumë në burg", ka thënë Shala, duke shtuar se ekziston edhe një mosgatishmëri e institucioneve kryesore në Kosovë që të japin

garanci të fuqishme. "Madje, madje, disi e kam bindjen që këta në njëfarë mënyre edhe punojnë që ata të dënohen, që të mos lirohen nga burgu. Dhe e gjithë kjo i shkon në favor Gjykatës Speciale që t'ua vazhdojë paraburgimin", ka thënë Shala.

Më tutje, Shala ka thënë se janë duke u shkelur të drejtat e njeriut me mbajtjen e tyre në paraburgim, duke shtuar se këtë nuk e ka bërë as Tribunali Ndërkombëtar për ish-Jugosllavinë. "Tribunali Ndërkombëtar për ish-Jugosllavinë ka qenë shumë më liberal në kuptimin e trajtimit të rrethanave qoftë në paraburgim, qoftë të dënuar, sepse i ka liruar më herët. Pra Gjykata Speciale është një gjykatë e cila në vend se ta bëjë një përparim në trajtimin e të provuarve nga liria, në këtë kontekst mendojmë se ka shkelje të të drejtave të njeriut, sidomos kur të kryhen hetimet e të fillojë procesi gjyqësor, atëherë nuk është e domosdoshme që të mbahen në arrest sepse ka përfunduar faza e hetimeve dhe nuk ka nevojë të mbahen. Por mosbesimi ndaj Kosovës, ndaj institucioneve të Kosovës, ndaj Shërbimit Korrektues të Kosovës, ndaj Policisë së Kosovës, të cilin e ka shfaqur hapur Gjykata Speciale në Hagë, është përcaktues që këta persona, në kundërshtim me të drejtat e njeriut, të mbahen në arrest", ka thënë Shala.

Në qendrën e paraburgimit në Hagë janë duke u mbajtur Hashim Thaçi, Kadri Veseli, Rexhep Selimi, Jakup Krasniqi, Hysni Gucati, Nasim Haradinaj, Salih Mustafa dhe Pjetër Shala.

Lushtaku viziton çlirimtarët në Hagë

HAGË, 4 GUSHT - Nënkrjetari i komunës së Skenderajt dhe ish-komandanti i Zonës Operative të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK) në Drenicë, Sami Lushtaku, ka vizituar liderët e UÇK-së në Hagë. Në "Facebook" ai ka publikuar një fotografi nga Haga. "Vizitë çlirimtarëve në Hagë", ka

shkruar Lushtaku. Një vizitë të tillë Lushtaku e kishte realizuar edhe para gjashtë muajsh, i shoqëruar nga gjenerali dhe ish-komandanti i Forcës së Sigurisë së Kosovës, Rrahman Rama dhe bashkëluftëtari i tyre, Hisni Thaçi. Hashim Thaçi, Kadri Veseli,

Rexhep Selimi dhe Jakup Krasniqi po mbahen në paraburgim në Hagë prej nëntorit të vitit 2020. Ata janë duke u akuzuar nga Gjykata Speciale kinse për krime lufte. Thaçi, Veseli, Selimi dhe Krasniqi janë deklaruar të pafajshëm në raport me akuzat e pretenduara.





TËRHIQET EDHE 25 PËR QIND E POLICËVE TË KOSOVËS NGA NDËRTESAT KOMUNALE NË VERI

Tjetër tërheqje e policëve nga veriu, Kurti: Po e zbatojmë marrëveshjen e Bratisllavës

Policia ka vazhduar tërheqjen nga objektet komunale në veri të Kosovës. Të premtën janë tërhequr edhe 25 për qind e policëve të Kosovës nga këto objekte, duke e çuar në 50 për qind numrin e përgjithshëm të policëve të tërhequr. Me këtë rast, kryeministri Albin Kurti ka thënë se janë duke e zbatuar me përgjegjësi dhe seriozitet marrëveshjen e Bratisllavës. “Kjo vjen pas vlerësimit të gjendjes së sigurisë nga mbledhja që pardje mbajtën drejtues të Policisë së Kosovës me EULEX-in dhe KFOR-in. Pra, siguria është e mirë, situata është e qetë dhe mund ta zvogëlojmë ca praninë e policisë sonë”, ka thënë Kurti. Ndërsa presidentja Vjosa Osmani ka folur rreth mbajtjes së zgjedhjeve në veri. Ajo ka thënë se mbajtja e këtyre zgjedhjeve nuk ka të bëjë fare me referendum

dezinformatave të ndryshme, prej atyre që janë pasojë e keqkuptimit, moskuptimit a keqinterpretimit të situatës dhe zhvillimeve e deri tek ato që janë dëshira antiqeveritare të transmetuara publikisht si lajme faktike. Lufta hibride kundër Republikës së pavarur të Kosovës dhe qeverisë së saj demokratike e progresiste do të dështojë”, ka shkruar kryeministri Kurti.

kryetarëve. “Iniciativa për largimin e kryetarëve tashmë është e paraparë me ligj, pra ekziston një ligj që ua njeh qytetarëve të të gjitha komunave të drejtën që përmes peticionit dhe pastaj rivotimit ta largojnë një kryetar komune përmes votës. Pra nuk është referendum, quhet kategori e largimit të kryetarit përmes procesit të rivotimit”, ka thënë Osmani.

Javë më parë ministri i Administrimit të Pushtetit Lokal, Elbert Krasniqi, ka thënë se zgjedhjet e parakohshme mund të zhvillohen nëse 20 për qind e votuesve në një komunë nënshkruajnë një peticion për largimin e kryetarit të asaj komune.

Ky peticion, sipas Krasniqit, do të dërgohej në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), që do ta verifikonte atë, më pas do të niste një referendum me pyetjen se a duhet të shkarkohet kryetari.

Në këtë drejtim, presidentja Osmani ka thënë se aktualisht pritet që të gjitha çështjet teknike të përcaktohen përmes një udhëzimi administrativ dhe që një grupi punuese, i krijuar për këtë punë, ta bëjë punën e vet. “Sapo të krijohet baza ligjore, qytetarët e këtyre komunave do të mund ta dorëzojnë peticionin.

Ky peticion duhet të vijë nga trupa votuese, nga votuesit e regjistruar”, ka thënë Osmani. Komuniteti ndërkombëtar i ka kërkuar Kosovës t’i organizojë këto zgjedhje për t’i ulur tensionet.

Osmani: Mbajtja e zgjedhjeve në veri s’ka të bëjë me referendum

Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, ka thënë të premtën se mbajtja e zgjedhjeve të reja në komunat veriore nuk ka të bëjë fare me referendum. Mbajtja e zgjedhjeve të reja në veri është pikë e marrëveshjes së arritur në mes të Kosovës dhe Bashkimit Evropian të arritur më 10 korrik për shtensionim të situatës në veri.

Tensionet janë rritur atje prej fundit të majit, pasi serbët lokalë e kanë kundërshtuar hyrjen e kryetarëve të rinj shqiptarë në komunat veriore - Zvečan, Leposaviq dhe Zubin Potok. Ata nuk i kanë pranuar kryetarët, ndonëse i kanë bojkotuar zgjedhjet.

Osmani ka thënë se ekzistojnë dy mundësi për mbajtje të zgjedhjeve të reja: që kryetarët të japin dorëheqje apo që qytetarët e këtyre komunave të kërkojnë përmes peticionit që të nisat procedura e largimit të

EPOKA E RE

Lirim GECI

PRISHTINË, 4 GUSHT (ER) - Policia e Kosovës ka konfirmuar se ka përfunduar shkurtimi i mëtejshëm i forcave policore në dhe rreth ndërtesave në veri në masën prej 25-përqindësh, sipas pajtimit që ishte arritur në Bratisllavë në mes të zëvendëskryeministrit Besnik Bislimi dhe emisarit të Bashkimit Evropian (BE) për dialogun Kosovë - Serbi, Miroslav Lajčak. Lajmin për tërheqjen e policisë e ka konfirmuar zëvendësdrejtori i Policisë së Kosovës për rajonin e veriut, Veton Elshani. “Ka përfunduar tërheqja. Tash kemi mbetur 50 për qind brenda dhe përreth objekteve komunale”, ka thënë Elshani.

Lidhur me tërheqjen e policisë nga ndërtesat komunale në veri ka deklaruar të premtën kryeministri i Kosovës, Albin Kurti. Ai ka thënë se kjo tërheqje ka ndodhur për shkak të situatës së mirë të sigurisë në veri. “Nga

sot filloi zvogëlimi edhe për 25 për qind i pranisë së Policisë së Kosovës në tri ndërtesat e komunave në veri të vendit tonë. Kjo vjen pas vlerësimit të gjendjes së sigurisë nga mbledhja që pardje mbajtën drejtues të Policisë së Kosovës me EULEX-in dhe KFOR-in. Pra, siguria është e mirë, situata është e qetë, dhe mund ta zvogëlojmë ca praninë e policisë sonë”, ka shkruar Kurti në “Facebook”. Në këtë kontekst, Kurti ka thënë se sundimi i ligjit dhe rendi publik po mirëmbahen gjithnjë e më shumë e më mirë. “Janë bërë rreth një muaj e gjysmë që nuk kemi incidente të theksuara e protesta të dhunshme. Falënderojmë policinë dhe qytetarët pa dallim për bashkëpunimin dhe korrektësinë. Ashtu qysh kemi thënë para më shumë se dy muajve: 1) nuk do të ketë zvogëlim të përnjëhershëm dhe as të menjëhershëm të pranisë së policisë, por vetëm gradual e proporcional; 2) zvogëlimi vlen për praninë policore në ndërtesat

komunale dhe rrethinat e tyre, e jo për veriun e vendit, ku ka ende sfida e punë për sundim të plotë të rendit e ligjit”, ka shkruar Kurti. Më tutje, ai ka thënë se janë duke e zbatuar me përgjegjësi dhe seriozitet marrëveshjen e Bratisllavës. “Ne po zbatojmë me përgjegjësi dhe seriozitet, sinqeritet dhe kujdes, marrëveshjen e Bratisllavës nga 10 korriku 2023 në funksion të kërkesave të BE-së nga 3 qershori 2023 për de-eskalim. Konstatimi i përbashkët me faktorët ndërkombëtarë për përmirësimin e dukshëm të nivelit të paqes dhe sigurisë në veri dëshmon për de-eskalim të qartë. Njëkohësisht, ne jemi vigjilent për ri-eskalimin potencial që mund të vijë nga deklaratat që nxisin urrejtje dhe agresiviteti politik e shtetëror i fqinjit tonë verior”, ka shkruar Kurti.

Duke iu referuar veriut të Kosovës, Kurti u ka bërë thirrje qytetarëve që të mos bien pre e dezinformatave. “Ftojme qytetarët që të mos bien pre e

PDK-ja: 900 ditë të qeverisë Kurti kanë prodhuar vetëm skandale

Prishtinë, 4 gusht (ER) - Sekretari për Marrëdhënie Ndërkombëtare i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Bernard Nikaj dhe avokati Faton Fetahu kanë denoncuar shkeljen e shtatë kushtetuese të qeverisë Kurti, me ç'rast është shpallur antikushtetues Ligji për Zyrarët Publikë. Nikaj në një konferencë për medie ka thënë se në këto 900 ditë të qeverisjes, qeveria Kurti është karakterizuar vetëm me skandale, afere korruptive, kapje të institucioneve dhe stagnim e degradim të politikës së jashtme. "Gjatë këtyre 900 ditëve, fatkeqësisht, qeveria është marrë shumë pak me qeverisje dhe është marrë tejet shumë me sulme kundër rendit kushtetues të vendit tonë. Siç e dini, Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës dje e ka shpallur antikushtetues Ligjin për Zyrarët Publikë pas kërkesës së grupit parlamentar të PDK-së për vlerësimin e kushtetutshmërisë së këtij ligji. Ndonëse shkeljet e pushtetarëve tashmë janë me qindra e po shtohen për çdo ditë, për të shtatën herë me radhë ky vendim konfirmon veprimtarinë



dhe aktivitetin antikushtetues të qeverisë së Albin Kurtit, e karakterizuar për skandale, afere korruptive, kapje të institucioneve dhe stagnim e degradim të politikës së

jashtme", ka thënë Nikaj. Sipas Nikajt, në vend se të ketë reflektim, llogaridhënie dhe marrje të përgjegjësisë për këto shkelje të vazhdueshme, po shihet vetëm një kryeneçësi të

qeverisë për t'i mbrojtur veprimet e saj joligjore. Ndërsa avokati Faton Fetahu ka thënë se ka prova të bollshme se sfidimi i sistemit kushtetues është veprimtaria më e

suksesshme e pushtetit të Albin Kurtit, të cilin, fatmirësisht, deputetët e grupit parlamentar të PDK-së janë duke e parandaluar. "Për shkak të përvojës relativisht të gjatë në procese kushtetuese, kam pasur fatin që të angazhohem në kapacitetin profesional në betejat kushtetuese që janë zhvilluar vitet e fundit, të cilat, padyshim, përbëjnë jo vetëm raste studimore për katedrat e drejtësisë kushtetuese, por paraqesin njëkohësisht edhe apetitet abuzive për pushtet të pakufizuar të bartësve të jetës institucionale të kësaj qeverie, si në mandatin e parë, ashtu edhe tani, në mandatin e dytë", ka thënë Fetahu, duke shtuar se PDK-ja nuk do të ndalet së angazhuari për të mos lejuar diktaturë dhe për të mos cenuar rendin demokratik në vendin tonë. "Si avokat dhe si përfaqësues i autorizuar i grupit parlamentar i PDK-së, ndihem i kënaqur dhe i lehtësuar kur shoh vullnetin e plotë të deputetëve për t'i qëndruar besnik betimit që ata e kanë dhënë për ta mbrojtur Kushtetutën dhe vlerat e saj", ka thënë Fetahu.

LDK-ja: Qeveria Kurti çdo ditë po merr kartonë të kuq, hyri në histori për shkelje të shumta të Kushtetutës

PRISHTINË, 4 GUSHT - Pas vlerësimit të Gjykatës Kushtetuese në lidhje me Ligjin për Zyrarët Publikë, Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) ka mbajtur të premten një konferencë për medie. Deputeti i LDK-së, Armend Zemaj, ka thënë se e kanë mirëpritur vendimin e Kushtetueses, duke shtuar se qeveria Kurti po i shkel të gjitha ligjet dhe Kushtetutën. Ai i ka numëruar të gjitha shkeljet që ka bërë kjo qeveri. "E kemi thirrur këtë konferencë për ta shprehur shqetësimin e thellë për shkeljet e vazhdueshme dhe të shumta të ligjit dhe Kushtetutës nga pushteti. Me një fjalë, ky pushtet është pushtet i shkeljeve ligjore dhe i ngeljeve kushtetuese. Po i përmendim vetëm disa nga ligjet e miratuara në Kuvend të Kosovës që janë dërguar dhe shqyrtuar në Gjykatën Kushtetuese, me ç'rast edhe një herë u dëshmuva se ky pushtet di vetëm ta shkelë Kushtetutën. Shkelja e parë ndodhi gjatë kohës së pandemisë Covid-19 1. Të shpallë që vendimi nr. 01/15 i Qeverisë së Republikës së Kosovës, i 23 marsit 2020, nuk është në përputhshmëri me nenin 55 [Kufizimi i të Drejtave dhe Lirive Themelore] të Kushtetutës në lidhje me nenet 35 [Liria e Lëvizjes], 36 [E drejta e privatësisë]. Shkelja e dytë. Edhe hera e dytë kishte të bënte me pandeminë Covid-19. Kësaj here u ataku vendimi i qeverisë Kurti për vendosjen e karantinës dhe

kundërvajtjet ndaj atyre që nuk i respektonin rregullat", ka thënë Zemaj, duke numëruar edhe disa shkelje të tjera të Kushtetutës nga ana e pushtetit. "Shkelja e tretë e Kushtetutës u krye nga ministrja e Arsimit, Arbërie Nagavci. Sipas vendimit të Gjykatës Kushtetuese, ministrja Arbërie Nagavci kishte ndërhyrë në kompetencat e komunës së Kamenicës për reformën në arsim e filluar nga ish-kryetari Qëndron Kastrati. Shkelja e katërt në muajin mars të vitit 2023, Gjykata Kushtetuese gjeti se ministrja e Drejtësisë, Albulena Haxhiu, e ka shkelur Kushtetutën. Gjykata shpalli antikushtetues Ligjin për Këshillin Prokurorial, i cili u hartua nga ministrja e Drejtësisë. Shkelja e pestë: Gjykata Kushtetuese e ka shpallur të pabazë vendimin e Kuvendit në vitin 2021 për ta shkarkuar të gjithë Bordin e RTK-së. Ndërsa mendojmë se këta janë edhe shkelës dhe ngelës potencial përballë Kushtetutës të Ligji për Pagat në sektorin publik, dhe ngelës përballë Kushtetutës të Ligji për masat e përkohshme të produkteve themelore në raste të veçanta të destabilizimit në treg", është shprehur Zemaj. Ai ka thënë se anëtarët e kabinetit qeveritar janë shkelës serikë të ligjit dhe Kushtetutës. "Ky pushtet ka hyrë në histori për të keq për shkelje të ligjit dhe Kushtetutës. Ky pushtet ka hyrë në histori për të keq kur ka bërë thirrje që ligjet të



mos i nënshtrohen vlerësimit nga Gjykata Kushtetuese. Pra, pushteti fillimisht ka bërë thirrje publike për shkelje të Kushtetutës dhe pastaj e ka shkelur. Që i bie se e ka shkelur me vetëdije dhe për qëllime politike e përfituese Kushtetutën e vendit. Ndryshe, i bie që ka bërë thirrje publike që anarkia të dominojë. Ka bërë thirrje publike që frikësimi të jetë lënda e parë qeverisëse. Ka bërë thirrje që të gjithë të jenë të frikësuar se pushteti është mbi ligjin dhe Kushtetutën. Ka bërë thirrje që ky pushtet me çdo çmim duhet të respektohet edhe kur aferat korruptive s'kanë të ndalur, edhe kur pasurohen paligjshëm, sepse këta të korruptuar potencialë nuk i

nënshtrohen ligjit, ngase do ta kenë mbrojtjen e Albinit", është shprehur Zemaj. Sipas tij, shkelja e ligjeve dhe e Kushtetutës nga pushteti aktual tashmë ka kaluar në normalitet. "Shkel mbi parimet. Shkel mbi të drejtat e njeriut. Shkel mbi mediet e pavarura. Shkel mbi gjithçka që është demokratike. Shkel mbi shtetin për pushtet", ka thënë Zemaj. Ndërsa koordinatori i Departamentit për Drejtësi në LDK, Shkëmb Manaj, ka thënë se qeveria Kurti çdo ditë po merr kartonë të kuq nga Gjykata Kushtetuese. Ai i ka ftuar të gjithë zyrtarët e shërbimit civil që të jenë në shërbim të shtetit të Kosovës. Në këtë kontekst, Manaj ka thënë

se LDK-ja administratën e shtetit nuk e konsideron administratë të partive politike. "Çdo ditë kemi ankesa nga zyrtarë të shtetit, çdo ditë e më shumë po marrin pushim pa pagesë vetëm për të mos qenë pjesë e këtyre vendimeve. Ky pushtet duhet të ndalet që të shpëtohet shteti i Kosovës. LDK-ja i fton të gjithë zyrtarët e shërbimit civil që të jenë në shërbim të shtetit të Kosovës. Për ne dallimi do të bëhet vetëm në ata që janë në zbatim të ligjit dhe ata që nuk janë. Qeveria jonë do të jetë në funksion të zhvillimit ekonomik dhe sundimit të ligjit. Kjo qeverisje antikushtetuese duhet të shkojë në shtëpi, andaj LDK-ja sot i jep karton të kuq", është shprehur Manaj.

1 184 operacione kryhen për gjashtë muaj në Klinikën e Kirurgjisë Abdominale

PRISHTINË, 4 GUSHT (ER) - Shërbimi Spitalor Klinik dhe Universitar i Kosovës (ShSKUK) ka njoftuar se në Klinikën e Kirurgjisë

Abdominale të Qendrës Klinike Universitare të Kosovës (QKUK) vetëm në gjashtëmuajorin e parë të vitit 2023 janë kryer 1 184

operacione të natyrave të ndryshme kirurgjike. “Po ashtu, mjekët dhe stafi i infermierëve të klinikës kanë kryer rreth 2 500 vizita

ambulantore, 216 ERCP, 106 gastroskopi, 99 kolonoksopi dhe shumë shërbime të tjera të kirurgjisë abdominale”, ka njoftuar ShSKUK-ja.



ORCA, aksion para Ministrisë së Arsimit: Pushteti po tenton t'i kapë agjencitë e pavarura

PRISHTINË, 4 GUSHT - Organizata për Rritjen e Cilësisë në Arsim (ORCA) përmes një aksioni protestues para Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHTI) ka denoncuar “tentimin për kapjen e agjencive të pavarura shtetërore nga eksponentët e pushtetit”. Drejtuesit e kësaj organizate para MASHTI-t kanë vendosur pankarta me mbishkrimin: “Tentim kapja e arsimit të lartë”.

Dibran Hoxha, koordinator i aktiviteteve në ORCA, ka thënë se kanë gjetur parregullsi në konkursin për përzgjedhje të anëtarëve të bordit të Agjencisë së Kosovës për Akreditim. Këto parregullsi kanë bërë që konkursi të anulohet por, sipas tij, një gjë e tillë ka ndikuar në rënien e interesimit të kandidatëve për të aplikuar në konkurs. Sipas tij, nga 26 kandidatë që kishin aplikuar, numri ka rënë në vetëm 17 për 4 fushat që kërkoheshin me konkurs. Për këtë pozitë ai ka pohuar se kishte aplikuar ish-kandidati i LV-së për deputet, Driton Vela, por që nuk e kishte marrë këtë pozitë për shkak se komisioni kishte zbuluar se ai kishte tentuar ta mashtronte duke deklaruar në CV-në e tij dhe në formularin e aplikimit se në vitin 2021 kishte qenë bartës i programit të doktoratës në mjekësi paraklinike në Universitetin e Prishtinës. Ai ka pohuar se edhe përkundër gjetjeve të tyre, shumë profesorë plagjiatorë e shkelës të ligjit janë duke e vazhduar punën në Universitetin e Prishtinës, duke e degraduar arsimin e lartë. “Më 24 maj të këtij viti patëm denoncuar parregullsitë e konkursit për përzgjedhje të anëtarëve të bordit të Agjencisë së Kosovës për Akreditim. Siç mund të jeni të informuar, konkursi kishte një sërë lëshimesh duke filluar nga shpërputhja mes vendimit dhe



UA e deri te mungesa e qëndrueshme e një sistemi të vlerësimit për kandidatët që kishin aplikuar. Si rrjedhojë e këtyre lëshimeve, që më vonë u paraqitën si teknike, Ministria Arbërie Nagavci më 7 qershor 2023 në mbledhjen e Qeverisë e anuloi konkursin për ta rishpallur atë 12 ditë më vonë. Si në rastin e parë edhe në të dytin, unë kam qenë monitorues i punës së komisionit i deleguar nga Koalicioni për arsimin e lartë - KITU. Në herën e dytë konkursi nuk kishte shpërputhje me UA, por rishpallja e tij reflektoi në rënien e interesimit të kandidatëve për të aplikuar në konkurs, kështu nga 26 kandidatë që kishin aplikuar numri ra në vetëm 17 total për 4 fushat që kërkoheshin me konkurs. Gjithsesi, në mesin e kandidatëve për këtë pozitë kaq të rëndësishme në sferën e arsimit të lartë, na bëri përshtypje aplikimi i eksponentit të pushtetit, ish-kandidatit të LV-së për deputetë, Driton Velës. Për fat të keq të tij e

të mirë të Kosovës, tentativa e Driton Velës për ta kapur këtë pozitë dështoi, meqë përgjatë shqyrtimit të aplikimeve komisioni zbuloi një fakt shokues. Driton Vela kishte tentuar ta mashtronte komisioni duke deklaruar në CV-në e tij dhe në formularin e aplikimit se në vitin 2021 kishte qenë bartës i programit të doktoratës në mjekësi paraklinike në Universitetin e Prishtinës. Kjo e dhënë po të mos zbulohet nga komisioni vlerësues, do bënte që ai me automatizëm të rangohej më lartë në listën e të rekomanduara për anëtarë të KShC-së”, ka thënë Hoxha, duke shtuar se pas verifikimit të këtyre pretendimeve, komisioni e kishte zbuluar mashtrimin e Driton Velës dhe me insistimin e fortë të anëtarës ndërkombëtare të komisionit Erika Eder, Vela ishte diskualifikuar nga konkursi. “Marrë parasysh këtë rrethanë, gjithashtu duke e ditur afërsinë e këtij personi me pushtetin, angazhimet e tij aktuale në Ministri të Shëndetësisë si dhe

duke pasur parasysh tentativat e tij në të kaluarën që të kontrabandojë ndryshimin e rregulloreve në Fakultet të Mjekësisë për t'i bërë vend vetes si profesor, u detyruam të bëjmë një hulumtim më të detajuar për punët e tij shkencore dhe pretendimeve për të arriturat e tij në të kaluarën”, ka thënë Hoxha. Më tutje, ai ka thënë se nga hulumtimi rezultoi se mashtrimi është rregull për Driton Velën dhe jo përjashtim. “Driton Vela mashtron kur thotë se ka qenë bartës i programit mjekësi paraklinike në UP. Ai i referohet një dokumenti të brendshëm që quhet RVV (Raport i Vetëvlerësimit) që fakultetet e paraqesin për akreditim pranë KShC-së, ndërsa KShC-ja ka marrë vendim që programi të akreditohet pa Driton Velën si bartës. Sipas vendimit bartësit e programit janë: Shaip Krasniqi, Hasime Qorraj-Bytyqi, Valdet Topciu-Shufta, Gazmend Kaccaniku dhe Livdana Spahiu. Driton Vela nga 13 artikuj të listuar në CV-në e tij, 10 janë

review articles, një është meta-analizë dhe vetëm dy janë artikuj shkencor original. Review articles dhe meta-analiza janë literaturë sekondare. Ato nuk prezantojnë të dhëna të reja nga puna hulumtuese eksperimentale e autorit, por ofrojnë analizë ose interpretim të hulumtimit parësor të kryer nga autorë të tjerë. Driton Vela është autorë i dy punimeve në revista të botuara nga Frontiers, botues i listuar si i dyshimtë në listën e Beall. ‘Shkencëtari’ Vela nuk ka ndonjë publikim në vitin 2022 dhe 2023 (burimi: ‘Google Scholar’ dhe ‘Scopus Author Search’). Driton Vela mashtron në ‘ResearchGate’, ku pretendon që ka një laborator “Driton Vela’s lab”. Në këtë laborator listohet një punim i botuar në Feseb Journal, ku ai nuk është fare autor”, ka thënë Hoxha. Sipas Hoxhës, “shkencëtari” Vela ka marrë pjesë në konferenca të Kosovës, Shqipërisë, Maqedonisë së Veriut dhe vetëm një në Turqi. “Nëse arritjet e tij qenkan aq të njohura pse nuk ka arritur të depërtojë përtej këtij qarku të ngushtë të vendeve të përmendura. Driton Vela mashtron sepse pretendon që përmes tekstit të tij mësimor ‘Fiziologjia e sistemit kardiovaskular’ mbulon tërë fushën në fjalë, ndërkaq teksti mbulon vetëm njërin nga fushat e fiziologjisë. Dhe për më tepër libri është i botuar nga ‘Educational Center Kosovo’, që boton kryesisht libra për mësim të gjuhëve të huaja. Driton Vela mashtron kur në njërin nga paraqitjet publike thotë se doktoratën e ka përfunduar në Shkup. Kjo është e pavërtetë. Ka dhjetëra postime të qasshme për publikun nga Universiteti i Prishtinës të cilat konfirmojnë përfundimin e doktoratës së Velës në UP”, ka thënë Hoxha nga ORCA.

Veterani i UÇK-së dhuron 20 mijë kilogramë miell për familjet nevojtare të Malishevës

MALISHEVË, 4 GUSHT (ER) - Veterani i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK), Ibush Zabelaj nga fshati Ngucat i komunës së Malishevës, ka dhuruar 20 mijë kilogramë miell për familjet në nevojë. Këtë donacion Zabelaj e ka dhënë zyrtarisht në komunën e Malishevës, duke ia dorëzuar kryetarit të kësaj

komune, Ekrem Kastrati. Me këtë rast, Zabelaj ka thënë se ndihet i lumtur për këtë veprim human. “Të ndihmohet të tjerët është njerëzore, por për mua si veteran i luftës më bën të ndihem mirë, pasi konsideroj se, përveç kontributit në luftë, po vazhdoj të njëjtën ta jap edhe tani, që brenda

mundësive t'i ndihmoj ata që kanë nevojë. Kontributi i të gjithë veteranëve nuk është vetëm në kohën e luftës, por edhe tani kur kemi mundësi dhe zemër”, ka thënë Zabelaj. Ndërsa kryetari i Malishevës, Ekrem Kastrati, ka falënderuar donatorin prej të cilit do të përfitojnë familjet në nevojë.



Dardan Krivaqa dënohet me burgim të përjetshëm për vrasjen e Marigona Osmanit

FERIZAJ, 4 GUSHT - Gjykata Themelore e Ferizajt e ka dënuar me burgim të përjetshëm Dardan Krivaqën për vrasjen e Marigona Osmanit. "Gjykata, të akuzuarit Dardan Krivaqa, për veprën penale 'vrasje e rëndë', i shqipton dënimin me burgim të përjetshëm", ka thënë gjyqtari Sahit Krasniqi, duke e lexuar vendimin, i cili është pritur me brohoritje dhe duartrokitje në sallë.

Ndërsa i dyshuari tjetër, Arbër Sejdiu, është dënuar me 15 vjet burgim për vrasje të rëndë. "Të akuzuarit Arbër Sejdiu, për veprën penale ndihmë në kryerjen e veprës penale vrasje e rëndë, (gjykata) i shqipton dënim me burgim në kohëzgjatje prej 15 vitesh", ka thënë gjyqtari Krasniqi.

Dy të akuzuarit, Krivaqa dhe Sejdiu, megjithatë janë liruar nga akuza e dhunimit, përkatësisht ndihmës në kryerjen e dhunimit pasi, sipas gjykatës, nuk ka pasur prova të mjaftueshme për të vërtetuar një gjë të tillë.

Avokati i familjes së Marigona Osmanit, Gazmend Rexhepi, ka thënë se familja është "e frustruar" lidhur me dënimin për të akuzuarin e dytë. Ai ka paralajmëruar ankesë sepse, siç



ka thënë, edhe akuzuari i dytë meriton burgim të përjetshëm. "Vrasja e Marigonës ka qenë vrasja më e rëndë në periudhën e pasluftës, sepse kronologjia e kësaj vrasjeje ka zgjatur 72 orë më herët se ajo të ndërrojë jetë", ka thënë ai.

Gjyqtari i rastit ka thënë se për dënimin e Krivaqës është marrë parasysh edhe mosha shumë e re e Marigona Osmanit e cila sapo

kishte mbushur 18 vjet.

Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, ka reaguar në lidhje me vendimin për dënimin me burgim të përjetshëm për Dardan Krivaqën për vrasjen e Marigona Osmanit. Ajo ka thënë se ky dënim duhet të jetë mesazh për të gjithë ata që zgjedhin dhunën ndaj grave si mjet. "Autorët e femicidit meritojnë dënim kapital. Ashtu siç u dënua sot

vrasësi e torturuesi i Marigona Osmanit. Le të jetë ky një mesazh për të gjithë ata që zgjedhin dhunën ndaj grave si mjet. Dhuna nuk do të tolerohet! Femicidi do të ndalet!", ka shkruar Osmani në "Facebook". Dënimi i Krivaqës është mirëpritur edhe nga ministrja e Drejtësisë, Albulena Haxhiu. "Marigona dhunshëm u nda nga jeta, në moshë tejet të re, pa pasur

mundësi të shohë perspektivën e jetës e ëndrrat të cilat nuk arriti t'i jetësonte. Marigona do të mbetet në kujtimet e të gjithë neve, me dhimbjen për ndarjen e saj nga kjo botë dhe mizorinë të cilën e përjetoi. Marigona nga sot do të kujtohet edhe si shpresa për të gjitha gratë viktime të dhunës e vrasjeve të cilat presin përgjigjet më profesionale nga sistemi i drejtësisë në vend. Si shpresa për drejtësi", ka shkruar Haxhiu në "Facebook".

Edhe organizata të ndryshme kanë reaguar për dënimin e Krivaqës.

Marigona Osmani ishte 18-vjeçare kur ishte vrarë më 22 gusht të vitit 2021 në banesën e të akuzuarit kryesor, Dardan Krivaqa, në qytetin e Ferizajt. Sipas aktakuzës, Dardan Krivaqa dyshohet se më 21 gusht 2021, rreth orës 10:14, në banesën e tij, pa pëlqimin e tani të ndjerës Marigona Osmani, e kishte detyruar atë të kryente marrëdhënie seksuale dhe e kishte abuzuar e maltretuar në forma të ndryshme. Një ditë më pas, më 22 gusht 2021, Krivaqa dhe Sejdiu akuzohen se kanë privuar nga jeta Marigona Osmanin, në përpjekje për ta fshehur veprën penale të dhunimit.

Selimi paralajmëron ofensivë të madhe amerikane: Brenda javësh do të ndodhë një vizitë e rëndësishme nga Shtëpia e Bardhë

PRISHINË, 4 GUSHT - Ish-ministri i Punëve të Jashtme, Petrit Selimi, ka paralajmëruar ofensivë diplomatike amerikane në Kosovë. Ai ka bërë me dije se brenda disa javësh në Kosovës do të ndodhë një vizitë e rëndësishme nga Shtëpia e Bardhë. "Jam në kontakt me miq në Uashington DC dhe teknjerëzit që e përcjellin aktivisht Ballkanin, që në këtë kohë krizash globale, nuk janë shumë në qeveri dhe Kongres. Ka një brengë të vazhdueshme se si implodoi procesi i dialogut në mes të Kosovës dhe Serbisë. Ka një shqetësim të qartë dhe faj që ia dedikojnë kryeministrit Kurti dhe ka një pajtim që Serbia nuk është aktor i besueshëm. Pra ka dëshpërim me Kosovën të cilën e konsideronin partnere dhe ka një mungesë besimi që Serbia do të përmirësohet në sjellje të vetat. Lëndimet e ushtarëve të NATO-s ishte një alarm, sepse fare lehtë ndonjë ushtar amerikan mund të vritej, dhe një incident i tillë dramatik do ta ndryshonte krejtësisht qasjen dhe pozitën e administratës Biden. Mendoj se edhe zgjedhjet presidenciale



amerikane janë në vëmendje të shumë njerëzve dhe nëse dëshirojnë të krijojnë një fitore në Ballkan, kjo është periudha e fundit që mund ta bëjnë këtë gjë", ka thënë Selimi në një intervistë për "Albanian Post". Ai ka thënë se disa veprime

amerikane do të jenë shumë të shpejta dhe do të shihen. "Besoj brenda disa javëve do të kemi një vizitë të rëndësishme nga Shtëpia e Bardhë e nivelit që mund të dërgojnë mesazh të qartë kryeministrit Kurti për pritshmëritë e presidentit Biden.

Potencialisht do të ketë edhe vizita tjera të nivelit të lartë në vjeshtë, nëse gjërat lëvizin në drejtim të pamohueshëm pozitiv. Ka edhe ndryshim konkret të personelit. Jim O'Brien po vjen në shtator, pas konfirmimit në Senat, në nivel të zëvendësit të sekretarit Blinken,

pra pozitë jashtëzakonisht e rëndësishme. James O'Brian në pozitën e tashmë si koordinator i sanksioneve, mu këto jave e sanksionoi Vulinin dhe kjo tregon se kemi një diplomat me informata të plota nga Ballkani dhe fuqi vendim-marrëse. O'Brian është i njohur për Kosovën, unë e kam takuar disa herë dhe ai ka miq personal në Ballkan, sidomos në Tiranë dhe Prishtinë. Ka këshilluar shumë njerëz përgjatë dekadave të fundit rreth situatës në Ballkan si në aspektin politik ashtu edhe ekonomik dhe e njeh intimisht edhe dialogun Kosovë - Serbi", ka thënë ai, duke shtuar se zëvendëse e O'Brianit do të jetë ambasadorja Yuri Kim. "Pra lëvizjet e personelit në Uashington, dhe një iniciativë direkte për të ndihmuar Kosovën të dalë nga vorbullat e vetëkrijuar e izolimit dhe keqkuptimit do të jetë dorë e shtruar e Kosovës", ka thënë Selimi.

Sipas tij, edhe Victoria Nuland, në një pozitë tjetër të lartë në Departament të Shtetit, është përfshirë rishtazi në dialog, ndërsa interesimi ka filluar të zgjidhet edhe te Këshilli për Siguri Kombëtare.

ATK-ja promovon të dhënat e hapura, Murtezaj thotë se po rritin transparencën dhe llogaridhënien

PRISHTINË, 4 GUSHT (ER) - Administrata Tatimore e Kosovës (ATK) ka mbajtur tryezën e diskutimit lidhur me promovimin e të dhënave të hapura, të publikuara në uebfaqen e ATK-së.

Zëvendësudrejtori ekzekutiv i ATK-së, Ilir Murtezaj, ka thënë se diskutimi në fjalë ka për qëllim të shërbejë si platformë për eksplorim të grupeve dhe të dhënave për të ilustruar se si këto të dhëna mund të përdoren për t'i kuptuar më mirë trendët e ekonomisë në Kosovë, por edhe për t'i informuar politikën e ekonomisë në të ardhmen. Madje, sipas tij, hapja e të dhënave është çelës për çdo institucion dhe organizatë për rritjen e transparencës dhe llogaridhënies. Murtezaj ka shtuar se çdoherë ATK-ja ka qenë e fokusuar që përmes planeve strategjike ta bëjë rritjen e mekanizmeve të cilat çojnë përpara integritetin e institucionit. Sipas tij, iniciativa për hapjen e të dhënave kontribuon në zhvillimin



demokratik të një institucioni si dhe zhvillimin e një segmenti ekonomik në nivel inovativ. "Për mua është kënaqësi t'ju informoj se ATK-ja është në vazhden e shumë reformave që është duke bërë. Është duke punuar edhe në rritje të integritetit si dhe të

transparencës. Ky është një hap tjetër drejt transparencës. Qëllimi është rritja e transparencës. Shkasi i kësaj iniciative është zbatimi i planit për përmirësimin e integritetit të institucionit të ATK-së dhe kërkesat e organizatave. ATK-ja deri tani ka hapur katër 'data

asete' që kanë të bëjnë me hyrjen dhe qarkullimin. Kësaj 'open date' i janë shtuar edhe gjashtë asete të reja dhe në total kemi 10 asete. Në këto asete kemi të bëjmë me deklarimin e numrit të punëtorëve, pagesat, rimbursimet etj.", ka thënë Murtezaj.

Ndërsa Dardane Peja, përfaqësuese e zyrtarit kontraktues në USAID, ka thënë se do të vazhdojnë ta mbështetin ATK-në edhe në të ardhmen, raporton "EO".

Në anën tjetër, Nora Kokaj, zëvendësudrejtoreshë e programit për qeverisje ekonomike në USAID, ka paraqitur para të pranishmëve qëllimin e këtyre të dhënave të hapura. Ajo ka thënë se ATK-ja është duke mbajtur hapin me shtetet e tjera të zhvilluara. "Të dhënat e hapura janë në treg në rritje edhe në vendet e zhvilluara. ATK-ja është duke mbajtur hapin me shtetet e tjera të zhvilluara. Shumë të dhëna mbi trendët ekonomikë publikohen me vonesa. Këto janë të dhëna administrative. Ato nuk zëvendësohen me statistikat zyrtare që publikohen nga agjencitë statistikore. Ato janë të hapura, janë të qasshme ligjërisht dhe teknikisht", ka thënë Kokaj. Ky organizim është mbështetur nga programi i USAID-it për qeverisje ekonomike në Kosovë.

Nisin hetimet ndaj disa ndërmarrjeve për rritjen e çmimit të vajit vitin e kaluar

PRISHTINË, 4 GUSHT (ER) - Autoriteti Kosovar i Konkurrencës (AKK) ka nisur hetimet ndaj disa ndërmarrjeve tregtare të cilat vitin e kaluar kishin rritur çmimin e vajit ushqimor.

AKK-ja ka njoftuar se vendimi për fillimin e hetimeve ndaj këtyre ndërmarrjeve është marrë të enjten në mbledhjen e këtij institucioni. "Dyshimet janë se ndërmarrjet kanë shkelur nenin 5, paragrafin (1), nënparagrafi (1.1) të Ligjit nr. 08/L-056 për mbrojtjen e konkurrencës ashtu që në mënyrë të drejtpërdrejtë ose tërthorazi kanë caktuar çmimet e shitblerjes ose çdo kusht tjetër tregtimi, për të vazhduar me paragrafin (1.2). Me këtë veprim kanë kufizuar ose kontrolluar prodhimin, tregjet, zhvillimin teknik ose investimet, si dhe



nenin 9, të Ligjit Nr. 08/L-056 për mbrojtjen e konkurrencës, paragrafi (2) nën paragrafi (2.1)

në mënyrë të drejtpërdrejt ose tërthorazi kanë vendosur çmime të padrejtë të shitjes ose

kushte tjera të padrejta tregtare, si dhe nën paragrafin (2.2) ndërmarrjet kanë kufizuar

prodhimin, tregjet ose zhvillimin teknologjik në dëm të konsumatorëve", ka njoftuar AKK-ja.

Autoriteti Kosovar i Konkurrencës (AKK) ka kërkuar nga ndërmarrjet që janë pjesë në proces të hetimeve që në afat prej 30 ditëve ta sjellin dokumentacionin që kanë të bëjnë me shitjet e vajit ushqimor me çmim 3.49 euro për litër në marsin e vitit 2022. AKK-ja ka njoftuar se fillimi i procedurës për hetimin e çrregullimit të konkurrencës ka për qëllim sqarimin e fakteve dhe në këtë mënyrë vërtetimin e shkeljeve të pretenduara. "AKK-ja do të marrë vendimin e saj meritor bazuar në faktet e vërtetuara të rastit dhe do të mbaj të informuar opinionin dhe qytetarët", ka njoftuar AKK-ja.

Çipsat nga Serbia përmbajnë substanca kancerogjene

ZAGREB, 4 GUSHT - Në kufirin kroat një nivel i lartë i një substance kancerogjene është gjetur në patatet e skuqura me shije speci të prodhuara në Serbi. Kështu është bërë me dije në faqen e internetit të Komisionit Evropian. Produkti nuk ka hyrë në tregun kroat dhe

është shkatërruar nga dogana në kufi. Substanca "akrilamide" nuk mund të gjenden në ushqimet e freskëta dhe formohen kryesisht gjatë përpunimit të ushqimit në temperatura mbi 120 gradë, si dhe në lagështi të ulët, që përfshin pjekjen, skuqjen dhe forma të tjera

të përgatitjes. Zakonisht gjenden në bukë, patate të skuqura, drithëra mëngjesi, biskota dhe kafe. Siç ka njoftuar Agjencia Kroate e Ushqimit, është vlerësuar se prania e "akrilamidit" në ushqim mund ta rrisë rrezikun e zhvillimit të kancerit në të gjitha grupmoshat.



Koleksioni i fermaneve turke të Kishës së Deçanit



Faton B. MEHMETAJ

Politika e carëve serb kundër popullsisë katolike të viseve arbërore, u intensifikua në kohën e sundimit të mbretërve Stefan Uroshi II (1282-1321), Stefan Uroshi III (1322-1331) dhe te Stefan Dushanit (1331-1355). Këta tre mbretër serb e fuqizuan mbretërinë serbe dhe e përkrashën kishën ortodokse, sidomos pas emërimit kryepeshkop të Savës që ishte djali i vogël i mbretit Stefan Nemanja, për mes të cilit u fuqizua kisha greko-sllave mision ky që u vazhduar nga kryepeshkopi Arsenije I-rë. Kjo periudhë përkon me prishjen përfundimtare të marrëdhënieve të Serbisë me Papatin dhe me fuqitë katolike, si me mbretërinë e Hungarisë dhe me anzhuinët francezë. Kundër banorëve arbëror katolik siç shkruhej edhe në "Kodin e Stefan Dushanit" të vitit 1349, shpallej hapur prishja e kishave nëse ata nuk ktheheshin në ortodokse, sekuestrimi i pasurisë, damkosja me hekur të nxehtë e klerikëve dhe banorëve, që refuzonin të ktheheshin në ortodoks, dëbimi nga trojet e tyre e deri dënimi me vdekje. Kjo situatë e rëndë, përshkruhet me shqetësim nga

kardinali Guido, në një letër dërguar Propagandës Fide në vitin 1350, i cili ankohet për masakrimin nga serbët të popullit të arbërit.

Duke i konsideruar arbërit katolikë, si elemente destabilizues dhe aleatë të Papës dhe të mbretërve përendimore, carët serbë zbatuan një politikë të egër, që erdhi duke u përpunuar doradorës dhe që gjeti shprehje të qartë. Disa nene të kodit të Dushanit, i kushtoheshin "shkuljes së herezisë katolike" dhe masave të rrepta kundër besimtarëve e klerikëve katolikë, që nuk pranonin të konvertoheshin në ortodoksinë serbe. Dokumente të shumta të asaj kohe, provojnë se këto masa kundër katolikëve në kodin e së drejtës mesjetare serbe, u zbatuan me egërsi, çka provokoj rebelim dhe kryengritjet e popullsisë arbërore, të shoqëruara me protesta të ashpra të Papatit, që arriti të bëj thirrje për organizim të kryqëzatës perëndimore për të shpëtuar popullsitë katolike nga shtypja e mbretërve "skizmatikë" të Rashës. Sikurse Perandoria Osmane që ndërmerre masa drastike për ti islamizuar shqiptarët, të njëjtën gjë e bënte edhe kisha ortodokse, edhe këta i përdorën të njëjtat presione ndaj shqiptarëve që të kalonin në këtë fe, (në fenë sllave serbe). Për ti vërtetuar pohimet e lartcekura po i përmendim disa të dhëna të akademikut serb Jovan Radoniq i cili ndër të tjera thotë: "Më 1662

priftërinjtë katolikë i janë drejtuar papës nëpërmjet misionarit Cezar Roza duke e lajmëruar këtë se patriku i Pejës ka marrë nga sulltani autorizime me të cilat të gjithë katolikët e Turqisë vihen nën pushtimin e tij. Këtyre u është ndaluar që t'i drejtohen Romës për mbrojtje, duke iu kërcënuar se nëse e bëjnë këtë gjë, do të dënohen me ngulje në hu". Arqipeshkvi i Shkupit Andrea Bogdani, lajmëron nga Janjeva me 1.XI.1664, Kongreacionin në Romë duke thënë: "Ortodoksët janë armiq të tërbuar të katolikëve njësoj si turqit. Patriku, i cili rri në Graçanicë, vetëm një milje larg Janjevës, përpiket që t'i zhdukë katolikët. Ai kërkon nga katolikët tatime krejtësisht të tjera nga ato që u paguajnë turqve". Nga ana tjetër, ekzistojnë dokumente historike që dëshmojnë se gjatë sundimit Osman kisha ortodokse në Kosovë ka pasur privilegje shumë të mëdha. Patriku i Pejës me dhurata të shumta, me ryshfete dhe me shërbime të tjera që i bënte sulltanit dhe autoriteteve të pushtetit turk në këto anë, ka arritur të fitojë simpatinë e tyre dhe përkrashjen e plotë. Popullsia shqiptare e këtyre viseve që ende e kishte ruajtur besimin e vet të vjetër katolik ka vuajtur më tepër nga kleri e patriku ortodoks i Pejës sesa nga pushteti turk. Se gjendja nuk ka ndryshuar shumë prej kohës në kohë, gjatë sundimit turk e paraqesin edhe dy fermanë të vitit 1600 të cilat tregojnë se rrethanat e jetës së kishës në atë kohë nuk kanë shumë dallim nga shekujt e mëparshëm. Sa herë që u keqësohej gjendja kishtarëve deçanas për shkak të problemeve që i nxinin me fshatarët e fshatrave përreth Deçanit të cilat nuk mund ti rregullonin vet, shkonin në Stamboll dhe vajtonin tek zyrtarët e perandorisë për ti ndrequr punët e tyre, dhe prej andej vinin me fermane për mbrojtjen e interesave të tyre nga "zullumi" (dëmi) që siç thoshin ata, ua bënin popullata shqiptare. Ankesa të tilla lidhur me këto probleme kishte bërë edhe *Igumeni Sergije, i cili e drejtonte kishën asokohe. Pas ankesës së Igumenit Sergije në Stamboll kundër shqiptarëve të Deçanit me rrethinë për prishjen e qetësisë rreth kishës, Sulltan Mehmeti IV përmes një fermani që ishte dhënë ndërmjet 6 e 16 shtatorit të vitit 1649, menjëherë pas ankesave të igumenit, përkitazi me tubimin e madh që ishte bërë me rastin e festës së Gospogjin më 28 gusht i kishte sqaruar të lartcekurit për këto probleme dhe kishte cekur se kush do që i thyen ligjet e vendosura nga perandoria ndëshkohet. Në mesin e këtyre fermanëve dhe akteve të tjera të*



Rekrutimi i fëmijëve të krishterë (miniaturë nga manskripti Sijlmaname)

pushtetit turk të kohës, ka të dhëna të mjaftueshme që tregojnë se edhe vet personeli kishtar i Kishës së Deçanit i thyente rregullat dhe ligjet kishtarë. Një ngjarje e tillë kishte ndodhur në vitin 1776, ku vet predikuesit e fesë ortodokse kanë bërë gabime e punë të palejuara në kishën e Deçanit.

Kështu, bie fjala, kallogjeri Metodije, i cili në vitin 1772 ishte betuar për besnikëri ndaj manastirit, e kishte shkëlur fjalën e dhënë dhe, ndihmat e mbledhura për kishën, i kishte marrë për vete, me çka kishte bërë një ("punë të keqe e cila nuk i përkiste"), "p aba ge a koja my e u ire". E Fermani i sulltanit urdhëronte mytesarifin e Qarkut të Dukagjinit, që kallogjeri të arrestohej, të hollat (paratë) t'i merren, ndërsa ai të internohej e të mbyllej në manastirin Kallafat në Sveti Gora.

Nga gjysma e dytë e shek. XIX e veçmas pas largimit të turqve nga Ballkani në vitin 1912, këto dokumente turke janë burimi kryesor për të mësuar jo vetëm historinë e manastirit të Deçanit, por edhe shumë më gjerë, për t'i njohur edhe rrethanat ekonomike-politike dhe pozitën juridike të kishës serbe nën qeverinë turke. Shumica e këtyre dokumenteve, sidomos ata që për

kishë ishin të rëndësishëm, kanë në fund të tyre ose në anën e kundërt një referencë, një sqarim rreth përmbajtjes së dokumentit të shkruar edhe nga monahu ose igumeni në gjuhën serbishte. Disa prej këtyre dokumenteve i përktheu konsulli rus në Prizren J. S. Jastrebov në vitet shtatëdhjetë të shek. XIX. Në vitin 1920 Mehmet-beg Sylejmanpashiq nga Travniku, duke kërkuar (gjurmuar) udhëheqësin e kishës Leontije Nivaković-in, i përktheu në gjuhën boshnjake të gjitha dokumentet turke që gjendeshin në kishën e Deçanit. Nga këto të dhëna mund të thuhet se nuk janë përkthyer të gjitha dokumentet e zënë ngojë këtu më sipër dhe aq më pak janë studiuar e publikuar, gjë që sjell mangësi të shumta për studimin e kohës së Mesjetës në këto anë. Këta dokumente janë shumë të qarta, meqë është dhënë saktë koha dhe vendi, kur ata janë shkruar. Me përmbajtjen e shkurtër që kanë këto dokumente të kishës, mund t'u shërbejnë studiuesve të rinj-historianëve dhe orientalistëve që duke i shfrytëzuar këto dokumente, t'i zgjerojnë njohjet e tyre për rrethanat e kohës së Mesjetës për këto treva. Ndër dokumentet turke më të rëndësishme të ruajtura në kishën e Deçanit janë **fermanët** (Urdhër i



Ferman i Sulejmanit II. 1558, DK-180

Sulltanit, urdhëresë, dëshmi) dhe **beratet** (Dekret i Sulltanit, dekret mbretëror përmes të cilit u ndahen-jepen titujt, dekoratat, privilegjet ose të mira tjera), që ka gjithsejtë 65 sosh. Këto dy farë dokumentesh janë lëshuar përnjëherësh, prandaj janë të përziera kuptimet e tyre, ndaj ka pasur mjaft paqartësi nga studiues të ndryshëm në përcaktimin e termave se cili nga këto akte është fermani e cili berat.

Fermanët dhe beratet e hershme të shek. XVI, kanë qenë të dimensioneve të vogla-gjerësia 15-20 cm. e gjatësia sipas nevojës. Janë shkruar me ngjyrë (majstillë) të zezë dhe janë të imët që është hedh mbi letrën e porsashkruar. Fermanët e mëvonshëm, të shek. XVIII e veçmas të shek. XIX janë të dimensioneve të mëdha, të gjerë më se gjysmë metri e të gjatë përtej 75 cm. Ka qenë një kohë sidomos gjatë shek XVII kur aktet e fermanit të sulltanit nuk kishin ndonjë vlerë, apo kishin pak efekt, sepse sundonin ligjet e të fortit me të cilat ligje deçanasit (kisha) ishte e njohur që nga shekujt e mëparshëm.

Përmbajtja e këtyre dokumenteve paraqet akte zyrtare të mbrojtjes së kishës dhe të vendit, që sulltanët turq përpiqeshin ta ruanin rendin dhe sistemin ligjor në perandorinë e tyre të gjerë. Përsëritja e urdhrave nënkuptonte faktin se drejtimi i pushtetit nga Stambolli i largët nuk ishte gjithaq efikas në provincat e largëta. Kjo do të thotë se **problemi i kishës së Deçanit**, për sa i përket pasurisë së patundshme të saj, ishte i njëjtë si gjatë shek. XVI, si në shek. XIX. Feudalët vendas kërkonin

ndonjëherë taksa edhe nga kisha, e cila me ligjet e pushtetit turk ishte e liruar nga taksat. Për këto shkaqe kishtarët deçanas kanë kërkuar ndihmë nga Porta e Lartë, prandaj këtij problemi iu kanë kushtuar 13 fermanë për një kohëzgjatje prej vitit 1506 e deri në vitin 1789. Fermani më i hershëm i vitit 1506, i Sulltan Bajazitit II, i ruajtur në kishën e Deçanit, vërteton se **subashët** (*Tagërmbledhës* - ai që mbledh taksat për beglerët dhe agallarët) dhe **timarxhinjtë** (*Timarxhinjtë* - timare - prona feudale) kanë kërkuar nga manastiri të dhjetën e sonës dhe të druve, për çka mitropolit i Pejës, Joanikija, është ankuar. Në ferman dërguar kadiut të Pejës, shkruan më tej se gjendja duhet të shikohet dhe, në qoftë se janë të sakta të dhënat e mitropolitit, në të ardhmen duhet ndaluar veprimin e subashëve e timarxhinjëve ndaj kishës së Deçanit, pasi që taksat e tilla janë ngarkesë për rajën, ndërsa kallogjerët dhe kishtarët nuk janë "raje e askujt", ndaj nuk janë të detyruar të paguajnë taksa. Problemi tjetër i kishës (që paraqitet në këta fermanë) ishte çështja e trashëgimisë së pasurisë së popëve, monahëve e mitropolitëve pas vdekjes së tyre. Deri në kohën e këtij fermani të vitit 1506, pasuria e tillë e udhëheqësve kishtarë i takonte vetëm kishës, ndërsa në këtë kohë (të këtij fermani) u paraqit trashëgimia familjare që pasardhësit trashëgonin këtë pasuri e jo kisha. Ky problem i kishës së Deçanit, sipas dokumenteve në shqyrtim, ka qenë aktual më se 300 vjet rresht. Akti më i vonshëm për këtë është fermani i vitit 1806. (Dok. nr. 8 i shkruar në Stamboll në vitin 1806

(turqisht i shkruar në muajin xhemaziul-ahira 1221). Fermanët e tillë janë dhënë, në të shpeshtën e rasteve, si përgjigje e lutjeve të episkopëve dhe mitropolitëve, të dërguar në Portën e Lartë zakonisht përmes Sinodit të Shenjtë të kishës greke, nën juridiksionin e së cilës ka qenë edhe kisha e Deçanit, pasi që iu hoq kjo detyrë patrikanës së Pejës në vitin 1766. Ka mjaft akte të tilla, afër 17 sish janë shkruar në periudhën 1783 deri më 1815, që kanë të bëjnë kryesisht me vërtetimin e të drejtave të mitropolitëve në mitropolitë (dioqezat) e tyre, pa ndërhyrjen e organeve civile të qeverisë turke. Disa dokumente të tillë kanë të bëjnë me lejimin e mbledhjes së ndihmave dhe tatimit kishtar, si dhe të lejohej kryerja e shërbimeve fetare nëpër shtëpitë private, pasi që siç dihet, në shek. XVIII, nuk kanë vepruar shumë kisha në trevat e mitropolisë së Novi Pazarit, ndaj lutjet fetare është dashur të mbahen nëpër shtëpia. Një hap i madh për riorganizimin e kishave ortodokse serbe është edhe akti i Sulltan Mustafës i vitit 1808, i cili përmes një berati urdhëron bashkimin e mitropolisë prizrenase me atë të Novi Pazarit, ndërsa mitropolit Joanikija të mbetet mitropolit-udhëheqës i mitropolisë së Prizrenit, Novo Bërdës, Prishtinës, Pejës, Vuçitërnës, Gjakovës, Novi Pazarit, Trgovishtës (Rozhajës) dhe Mitrovicës. Dokumenti ka një pamje të bukur. Është ky dokumenti më i zbukuruar dhe më i larti i fermanëve në kishën e Deçanit.

BERAT I SULLTAN MUSTAFAIT IV


Shkruar me bojë të zezë e të kuqe e ar në letër, tugra është e artë, ngjyrosur me temper të kuq, të kaltër e të kaftë. Pjesa e epërme e mvëshur me mëndafsh, 140x50,6 cm.

Shkruar në Stamboll në vitin 1808. Signatura DK-13.

Në pjesën e epërme të dokumentit është turga, e kaluar me një trekëndësh të mbushur me motive lulesh dhe vizatime ari. Majtas e djathtas lart janë dy lule të kuqe trëndafilli dhe dy selvi të arta.

Me kërkesën e patrikanës së Stambollit, bashkohen mitropolitë e Prizrenit e Novi Pazarit në një mitropoli, dhe mitropolit Joanikije bëhet mitropolit i Prizrenit, Novobërdës, Prishtinës, Pejës, Vuçitërnës, Gjakovës, Novi Pazarit, Tërgovishtit, Mitrovicës dhe kleri i rajonit duhet t'i nënshtrohet. Me berat i jepet mbrojtje mitropolitit për kryerje të papenguar të detyrave të tij. Shkruar më 4 sefer të vitit 1223 në Stamboll (1808). Vërejtje: I konservuar.

Aktet tjera mbretërore në gjuhën turqishte të ruajtura në Deçan, kanë të bëjnë, në pjesën më të madhe të tyre, me vet kishën e Deçanit si dhe kushtet e rrethanat e veprimit të kësaj kisha. Ka dokumente që tregojnë obligimet e igumenit deçanas si **sokollar**, do të thotë si shahinxhi,



Berat i Selimit II. 1568, DK-173

shahindogaxhi, shahinkajaxhi, me çka i siguroi kishës së Deçanit privilegje të veçanta. Si sokollar, igumanët deçanas ishin nën mbikëqyrjen e drejtpërdrejt të sulltanit, ndërsa tokat që kishin – pra pronat tokësore të kishës së Deçanit kanë qenë të liruara nga paga e të dhjetave dhe pagesave të tjera.


Nga fermanët e ruajtur të Deçanit del se beratit i parë shahinxhi i është dhënë igumenit deçanas në vitin 1516, që është përsëritur në vitin 1543 dhe përsëri është vërtetuar në vitin 1565, për t'u dhënë edhe më tej vazhdimisht në vitet 1582, 1662, 1776 dhe në vitin 1778. Ndërkaq, në mes akteve të Deçanit është ruajtur edhe një vërtetim i lëshuar nga Sulltan Murati III në vitin 1574, ku bëhet fjalë për doganxhillëkun deçanas, që dëshmon për kryerjen e kësaj detyre të kishës së Deçanit për ç'gjë ka pasur privilegje nga qeveria turke që nga koha kur Deçani u pushtua nga turqit për herë të parë në vitin 1439-1444. Ligjet turke ishin të fuqizuara në atë mënyrë që çdo ndryshim në fronin mbretëror tërhiqte edhe përsëritjen e akteve mbretërore të lëshuara nga sulltani i mëparshëm, pasi që vlera e akteve mund të aplikohet vetëm gjatë sundimit të atij sulltani që lëshonte aktin (dokumentin).

Përmes fermanëve sulltani merrte nën mbrojtje kishën e Deçanit edhe nga pengesat që mund të shkaktonin organet lokale me rastin e rimeremetimit dhe ndërtimit të ndonjë muri të rrëzuar, të ndonjë konaku të kishës etj. Kështu igumeni deçanas Danillo Kazhanegra në vitin 1778, u detyrua që të ankohej në Portën e Lartë për shkakun se policia lokale e pengonte të

rindërtonte disa pjesë të ndërtesës së kishës. Përkritazi me këtë çështje, sulltan Abdullah Hamidi I e shkroi fermanin dhe ia drejtoi kadiut të Gjakovës duke e njoftuar atë që të vepronte sipas fermanit të mbretit dhe të mos i lejonte policinë që ta pengonin igumenin e Deçanit, që të rindërtonte pjesët e nevojshme të kishës.

Fermani i Sulltan Sylejmanit II të Madhërishtëm (nga libri i M. Shakotës – Sulejman Veli an-Stveni) i vitit 1558, flet për përpjekjet e spahive vendas që donin të gërmonin themelin dhe vendin e truallit ku gjendet kisha e Deçanit për të kërkuar minierën e argjendit. Fermani i Sulltan Sylejmanit u dërgohet bejlerëve të Sanxhakut dhe kadiut të Pejës në emër të kallogjerëve të kishës së Deçanit, pasi që kallogjeri deçanas Toma kishte vajtur në Stamboll, në zyrën e mbretit dhe kishte deklaruar se spahiu Nuho Topçuoğlu dëshiron të gërmojë themelet e kishës si dhe vendin nën altar për të vërtetuar gjendjen se a ka apo nuk ka xehe argjendi në truallin e kësaj kisha. Ky ferman (tregon) se si spahia Nuho Topçuoğlu ka tentuar ta rrëzojë kishën duke këruar madenin (Xehen) e argjendit në themelet e altarit të kishës.

Përmes këtij fermani urdhërohet kadiu i Pejës që ta vërtetonte gjendjen se a gjendej xehja e argjendit këtu apo jo, ndërsa spahiu duhet penguar çasjet rreth këtij manastiri si dhe kërcënimet e fyerjet e mëtejme. Dokumenti është shkruar në Jedrene, sipas turqishtes, me datën 24 xhemazi-el-evela të vitit 965 (pra më 14. III. 1558). Në pjesën e sprasme të këtij dokumenti gjenden dy dorëshkrime të ndryshme në gjuhën serbishte me një alfabet



Ferman i Mustafës IV, 1808, dteaj

cirilik mjaft të ndërlikuar. Për mes akteve zyrtare të sulltanit-fermanëve e berateve-është mbrojtur edhe vet organizimi i kishës nga personat kishtarë që kanë vepruar kundër interesave të kishës. Ka ndodhur që kallogjeri i dërguar në "pisaniju" - zyrtarisht në detyrën kishtarë, e ka keqpërdorur besimin e igumenit dhe ndihmat e mbledhura për kishë i ka ndalë për veten e tij. Kështu ka vepruar kallogjeri Metodije në vitin 1776, i cili është ndjekur dhe arrestuar me urdhër të sulltanit, pasi që është vërtetuar se ky person është paraqitur si "mitropolit i rrejtshëm" dhe i ka munduar fshatarësinë e vendbanimeve përreth kishës-rajën, siç quhej asokohe popullata e nënshtruar. Siç është thënë edhe këtu më parë, kallogjeri Metodije u transferua në manastirin Sv. Avramia në Sveti Gorë në vitin 1779.

Nuk përjashtohet mundësia që veprimtaria e këtij kallogjeri ka qenë e drejtuar kundër drejtorisë greke të kishës serbe, ashtu siç është shpjeguar ky ferman edhe nga J. S. Jastrebov. (Fermanin në fjalë Jastrebovi e radhitë në grupin e akteve - fermanëve që flasin për ndërprerjen - heqjen e patriarkaleve serbe). Që kjo drejtori e ka munduar popullatën dëshmon edhe fermani i vitit 1804, me të cilin akt mbrohet raja nga "zullumi" - dëmet, që bënin ndaj saj mitropoli dhe episkopët grekë.

Në disa fermanë bëhet fjalë për përvetësimin e paligjshëm të pronave tokësore të kishës nga banorët e fshatrave përreth, para se gjithash, banorët e fshatit Isniq, të cilët janë përpjekur t'i marrin pasuritë (tokat) e Bivolakut.

Burulli e Abdurahmanit, Mytesarif i Dukagjinit

Bojë e zezë në letër, 46x32 cm
Shkruar në vitin 1801.

Signatura DK-305

Abdurahmani, mytesarif i Dukagjinit, lëshon këtë akt me të cilin mbrohet manastiri i Deçanit nga pagesa e taksës së gjakut për vrasjen në fshatin Bivolak dhe urdhëron myteselimin e Pejës që të bëjë përpjekje që isniqasit t'ia paguajnë obligimet e tyre manastirit të Deçanit. Shkruar me 5 xhemazi-el-evela të vitit 1215 (1801).

Në faqen e pasme, me dorën e Haxhi-Danilovit [serbishte e vjetër]

Vërejtje: ngjyra e përlyer, letra e përlyer, e dëmtuar në palosje. muaji i pestë i kalendarit islamik

Bivolaku që është përmendur edhe këtu edhe më parë, sipas Krisobulës së vitit 1330, ishte paralagje e vendbanimit mesjetar Isniq, asokohe me 9 shtëpi të vendosura në fushën më pjellore të trevës së Deçanit me rrethinë që sot i thonë Divolaçe. Aktet zyrtare të qeverisë turke - fermanet, beratet etj, që u trajtuan në këtë shqyrtim, në të shpesh të rasteve, i ka vendosur pushteti i kohës në leverdi të shoqërisë kishtarë të Deçanit. Përmes këtyre

fermanëve të pushtetit të lartë turk janë urdhëruar organet lokale të nahijeve, sanxhaqeve që t'i peshojnë drejtë problemet juridike dhe të vendoset në anën e atij që ka të drejtë sipas dëshmimeve, dokumenteve etj.

Një ferman tjetër po i vitit 1847 i drejtohet valiut të Shkupit, vezirit Hafis pasha si dhe kajmekamit të Sanxhakut të Prizrenit, Omer pashës si dhe Parisë së Pejës, sipas ankesës së Manastirit të Deçanit, se banorët: Sylejmani, Ahmeti, Mavsuti (Maksuti), Idrizi, Sadiku dhe Osmani, të fshatit Deçan kanë uzurpuar arat e manastirit "Blovac" e "Daterler" që monahët i kanë qelë rrah dhe i kanë kthyer në tokë pune, "Si është e shkruar në libra që arat i përkasin kishës", ndaloni pengesat e mëtejme të banorëve deçanas. Të njëjtit banorë deçanas që u cekën këtu më sipër përmenden edhe në një ferman tjetër, të po të njëjtit vit vetëm jo për "uzurpimin" e arave, por tani për "uzurpimin" e vreshtave në të njëjtin fshat (Deçan).

Dorëshkrimi serbisht i monahëve deçanas (në shpinë të dokumenteve turke), edhe pse disa herë i pakuptueshëm për shkak të alfabetit të përzier me ndonjë fonemë rusisht ose greqisht, ka rëndësi për saktësinë e datave si dhe të përmbajtjes së tyre.

Është mjaft e qartë dhe karakteristike e këtyre fermanëve e berateve të sulltanit se në shumicën e tyre jepet urdhër i prerë që të verifikohet gjendja në vendin e ngjarjes nga organet juridike lokale dhe e gjithë lënda të peshohet me kujdes dhe të vendoset drejtësia ligjore; fajtorët gjithsesi të pengohen. Fermani i vitit 1799 kërkon hetimin dhe sqarimin e gjendjes për kallogjerin Vasilije, të birin e Haxhi Radit nga Novi Pazari sepse, kinse ka vepruar kundër ligjeve fetare, ose siç thotë igumani Danillo në shkrimin serbisht në dokument "i ka bërë zullum-dëm kishës". Derisa ky "zullum ndaj kishës" nuk është shpjeguar, ka ndodhur krejt ndryshe rasti me veprimin e kallogjerëve deçanas Ananija, Mihajli, Arsenija, Sarafija, Vignorija, Georgija dhe Sava, të cilët e kanë dëmtuar rëndë riznicën e Deçanit, duke bartur nga manastiri një barrë të plotë- ngarkesë "orendi të argjendta dhe mjete të tjera" në vitin 1648. Për këtë skandal e vjedhje që bënë kallogjerët në kishën e tyre, kadiu i rrethit të Altun-Ilisë, Mehmeti, u dërgon urdhëresë (emar) të gjitha organeve shtetërore që kallogjerët e përmendur këtu më sipër të kapen menjëherë dhe t'i dorëzohen kishës së Deçanit.

EMAR

Bojë e zezë, me vulë në fund, 21x25 cm.

Shkruar në vitin 1648.

Signatura DK-69.

Shkruar nga Mehmedi, kadi i rrethi Altun-Ilia. Në padinë e murgjve të manastirit të Deçanit

se Ananije, Mihaili, Arsenije, Sarafije, Vignorije, Georgije e Sava kanë marrë nga manastiri gjesende të argjendta e të tjera ndoshta një ngarkesë dhe kanë ikur, urdhërohen të gjitha organet shtetërore që murgjit e përmendur të kapen e të dorëzohen manastirit. Nënshkruar nga katër dëshmitarë myslimanë, katër të krishterë dhe igumeni. Shkruar në muajin safer të vitit 1058 (1648).

Në faqen e pasme, me dorëshkrim të Haxhi Danilovit: (serbishte e vjetër)

Vërejtje: I konservuar.

Sipas këtij dokumenti mund të vërtetohet se çështja e kishës së Deçanit dhe zhvillimi i mëtejme i veprimtarisë së saj fetare po kalonte nga organet mbretërore edhe në organet e pushtetit lokal, që pashallarët dhe valinjët lëshonin dokumente - **bujrulldi**, mandej kadijtë e mytevelijët gjithashtu jepnin urdhëresa dhe zbatonin ligjet e shtetit përmes dokumenteve zyrtare: **huxhete**, **murasele**, **fetfa** e deri te bejlerët e agallarët me dokumentet e tyre: **izunet**, **teskeret**, etj. Koleksioni i dokumenteve-burulldivë-urdhëresave, i shpalljeve të valive, pashallarëve dhe myteserrifëve përkritazi me kishën e Deçanit është i pasur. Janë ruajtur 16 burulldi të tilla që mbronin interesat e kishës sonë nga dhunimet a keqpërdorimet e organeve lokale. Nëse burullditë nuk bënin efektin e duhur, atëherë kishtarët deçanas ankoreshin në pushtetin qendror të shkallës më të lartë në Stamboll. Si urdhërdhënës përmes burulldivë kanë qenë të paraqitur pashallarët e Pejës, të Shkodrës, Gjakovës, Junikut (rrethi i Altun-Ilit), të Prizrenit dhe të Rumelisë si dhe myteserrifi (kryeshëfi) i qarkut të Nishit. Kuptimi i këtyre dokumenteve ishte i orientuar kah mbrojtja e kishës dhe njerëzve të saj nga dëmet (zullumet), mandej kundër pengesave të pasurisë (tokave) të kishës që ndonjëherë pengonin spahijtë ose banorët e fshatrave të afërta, që përvetësonin tokën e punuar të kishës, kur pashai ndonjëherë hidhte anash të drejtat poseduese të kishës. Dy nga këto burulldi e mbrojnë kishën nga pagesa e tatimit, që kisha ka qenë me ligj e liruar nga tatimi.

BUJRULLDI E MAHMUD-PASHËS SË GJAKOVËS

Bojë e zezë në letër, me kokrra rëre dhe vulë në fundm 42x29,2 cm.


Shkruar në vitin 1818.

Signatura DK-269.

Me lutjen e igumenit të Deçanit Mehmed (Mahmud) pasha emëron vojvodën e manastirit të Deçanit me detyrë për ta mbrojtur manastirin nga sulmet e fyerjet. Në vitin 1233 (1818).

Në faqen e pasme: 1818 (serbishte e vjetër)

Vërejtje: Letra e ruajtur mirë, e përlyer me bojë të derdhur. Nuk është publikuar.



Diptik kryepeshkopit e kryemurgut të manastirit të patrikanës së Pejës shek. XVI-XVII, DK-363.

Beteja e re e Kosovës - për historinë dhe lojalitetin e “kosovaro-serbëve”

Gjendja e pezullt e serbëve të Kosovës dhe fuqia e Serbisë që t’i sponsorizojë projektet e tyre iredentiste, do t’i prodhojë në mënyrë serike personazhet e tipit të Millosh Obiliqit, Sholleviqit e Radojçiqit derisa serbët e Kosovës të rehabilitohen e të integrohen në shtetin e ri



Milazim KRASNIQI

Ku e kanë burimin historik dhe motivimin ideologjik e religjioz sloganet militante serbe: “Kosova është Serbi”, “Kosova është tokë e shenjtë serbe”, “Kosova është Jerusalem serb”, “Të hakmerremi për Kosovën?” A janë produkt i kujtesës historike kombëtare, apo produkt i ideologjisë imperiale pansllaviste dhe religjioze ortodokse? Si mund të zbuten që të mos vazhdojnë të mbeten malinje për paqen në rajon këto ideologema luftënxitëse e hakmarrëse? A mund të dekonstruktohen në kohën tonë, në frymën e Postmodernizmit, ku narracionet e mëdha jo vetëm mund të dekonstruktohen, por edhe të shndërrohen nganjëherë në objekte të lehta cinizmi relaksues. Sa e si mund të ndihmojnë shqiptarët në çmontimin e mitit serb për Kosovën? Dhe ajo që është posaçërisht e rëndësishme: sa e si mund të

kontribuojnë serbët e Kosovës në atë çmontim mitesh e ideologemash malinje dhe përtej tyre ta realizojnë bashkëjetesën paqësore me shqiptarët në një Kosovë të pavarur, duke ruajtur identitetin e vet kombëtar, pa u instrumentalizuar nga politikat imperiale të Serbisë kundër Kosovës së pavarur? Këto pyetje prekin jo vetëm në palcën e çështjes identitare serbe e perspektivën e raporteve serbo-shqiptare, po edhe në vetë mundësinë e ekzistencës së shtetit të Kosovës dhe rolit që u është rezervuar në tërë këtë sfond serbëve të Kosovës.

Akademizmi i përgjunjur në të kaluarën dhe i përgjumur sot

Si të tilla këto pyetje e tejkalojnë kornizën e një teksti që shkruhet për një numër të një reviste, sado prestigjioze

që të jetë ajo. Në fakt, përgjigje në këto pyetje do të duhej të kishte dhënë tashmë historiografia shqiptare, antropologjia kulturore dhe religjiografia. Por, nuk kanë dhënë. Përkundrazi, ato kanë vazhduar e vazhdojnë ende, ndonëse gjithnjë e më të ndrojtura, që të përkrahin narrativën serbe mbi Kosovën, veç maskuar është fjala për Betejën e Kosovës. Duke e përkrahë versionin serb mbi Betejën e Kosovës, në fakt legjitimohen të gjitha mitet, propaganda, sloganet dhe ideologjitë militante serbe, sepse tharmi i identitetit kombëtar serb është pikërisht ajo ngjarje. Nëse e pranoni versionin serb mbi Betejën e Kosovës, e keni pranuar në pako edhe versionin mbi tapinë-pronësinë serbe mbi këtë territor. Për të qenë pak në konkret: nëse e glorifikoni Betejën e Kosovës si një projekt vetëmbrojtës e

çlirimtar serb (e ballkanik) kundër osmanëve, në fakt e trasoni rrugën që të arsyetohet ideologjikisht edhe pushtimi i Kosovës në vitin 1912 nga Serbia, sepse pushtimi i vitit 1912 është justifikuar pikërisht me të drejtën historike serbe që e ka burimin te Beteja e Kosovës. A është e qartë se sa naive është qasja e pjesës dërrmuese të historiografisë sonë? Po ashtu, nëse e glorifikoni Betejën e Kosovës si projekt të përbashkët serbo-shqiptar a edhe gjithë ballkanik, atëherë nuk mund të mbron kauzën e një shteti të pavarur të Kosovës, i cili formalisht është multientik, pra as serb as shqiptar. Brenda atij perceptimi, të multienticitetit (as, as) Kosova duket shtet në një vakum, i cili së shpejti duhet të mbushet me ndonjë përmbajtje tjetër. Nëse e glorifikoni bashkëpunimin shqiptaro-serb, nuk mund të jeni kundër projektit të

Pashiqit “Ballkani ballkanasve” dhe projekteve që ka derivuar deri te shëmtira e fundit politike, “Ballkani i Hapur”, i cili proklamonte bashkëveprimin serbo-shqiptar, por pa “shtetin vakum” pra pa Kosovën, më saktë kundër Kosovës. Me një fjalë, shkencat albanologjike nuk kanë ndihmuar në sqarimin e duhur të këtyre problemeve historike, religjioze, politike, demografike, që ngarkojnë marrëdhëniet shqiptaro-serbe dhe i mbajnë në gjendje lufte edhe kur ajo nuk është e shpallët, ose kur është një gjendje armpushimi, sikundër është kjo gjendja e tashme e arritur me Marrëveshjen Ushtarake-Teknike të 9 qershorit ndërmjet NATO-s dhe ish RFJ-së. Natyrisht, publicistika nuk mund ta zëvendësojë asnjëherë studimin mirëfilli shkencor. Bile as në rastin “kur nuk ka shi, bën edhe breshër.” Por,

publicistika nuk ka pse vegjeton, nëse shkenca po vegjeton. E pakta që mund të bëjë publicistika në këto kushte është të shtrojë pyetje si këto që u shtruan në fillim dhe të përpiqet të nxisë që të japin përgjigje ata që eventualisht i dinë ato përgjigje.

Disa përgjigje dihen, por fshihen. Pse fshihen?

Nëse nisemi nga pjesa e parë e pyetjes që u bë në fillim të këtij teksti, (ku e kanë burimin historik dhe motivimin ideologjik e religjioz sloganet militante serbe: “Kosova është Serbi” dhe derivatet e saj) mund të themi si vijon: në kohën që llogaritet si ngjizja e këtij miti, në vitin 1389, kishte serbë në Kosovë, por nuk kishte shtet serb, nuk kishte Serbi. Vuk Brankoviç ishte sundimtar në Prishtinë, ndërsa Lllazar Hrebllanoviç e administronte nga Krushevcu edhe Novo Bërdën. Ishin sundues të dalë nga procesi i shpërbërjes së shtetit mesjetar të Dushanit dhe ishin në rivalitete e në konflikte ndërmjet vetes e sidomos me Kraleviç Markun, i cili sundonte në Prilep, si trashëgimtar i mbretit Vukashin Mrnjavçeviç, i kontestuar edhe ai. Pra, nëse Beteja e Kosovës konsiderohet si tharmi i mitit se Kosova është Serbi, atëherë del të jetë pohim tërësisht i pavërtetë, sepse Serbi në atë kohë nuk kishte. Kishte Fushë-Kosovë, por nuk kishte Serbi. Osmanët edhe erdhën në këtë rajon, për ta plotësuar vakuumin gjeopolitik që kishte ngelë pas shpërbërjes së shtetit të Dushanit, më saktë, pas vdekjes së pasardhësit të fundit nemanjid, Uroshit dhe katastrofës serbe në Maricë më 1371. Brenda logjikës historike të atyre proceseve dhe ngjarjeve, atdheu simbolik i Serbisë do të duhej të kërkohej që të ribëhej në Maricë, ku u shkatërrua shteti serb në vitin 1371. Në fakt, në Betejën e Kosovës kishte luftë civile ndërmjet serbëve, ndërsa osmanët ishin të ftuarit e Kraleviç Markut, të vetmit sundimtar legjitim serb që kishte mbetur pas katastrofës së vitit 1371. Shkurt, në vitin 1389 nuk kishte një shtet që të quhej Serbi, prandaj Kosova as nuk ishte e as nuk mund të quhet Serbi. Ata e quanin Kosovën “Serbi e Vjetër” shumë më vonë, në kohën e rilindjes kombëtare serbe. E dyta, pas disfatës në Betejën e Kosovës, (1389) ku Vuk Brankoviç u etiketua si tradhtar e mandej u bë vasal osman, asgjë serbe nuk kishte mbetur që të ishte legjitime. Bijtë e Lllazarit pranuan po atë ditë vasalitetin dhe madje ia dhanë për nuse sulltan

Bajazitit motrën e tyre, Milevën. Çka ka këtu për t’u krenuar? Krenari me tradhtinë e Vuk Brankoviçit? Krenari me vasalitetin e bijve të Lllazarit? Krenari me të bijën e tij, Mileven, e cila shkoi po atë natë në shtratin e fitimtarit, i cili ia vrau babën? Krenari me Serbinë, e cila për aq sa ekzistonte, në mbeturinat e shtetit të Dushanit, u shkatërrua në një pasdite të vetme? Prandaj konkluzioni i saktë është se Kosova në atë kohë nuk ka qenë Serbi. Më shumë mund të ishte e vërtetë potë ishte thënë se Marica a Çernomeni ishin Serbi, se sa që thuhet për Kosovën. Ndërsa slogani “Osvetiti Kosovo” (Të hakmerremi për Kosovën) ka të bëjë me përpjekjen serbe për ta arsyetuar pretendimin gjenocidal serb kundër shqiptarëve të Kosovës në kohën e re, në shekullin XX. Ja si funksionon kjo ideologji gjenocidale: duhet të hakmerremi në shekujt XX-XXI për një humbje që e kemi përjetuar në shekullin XIV. E dyta, duhet t’i hakmerremi një popullit tjetër, popullit shqiptar, ani pse në shekullin XIV na kanë shkaktuar disfatë osmanët. Si paktohet thirrja për hakmarrje ndaj shqiptarëve dhe ndaj boshnjakëve? Hakmarrja ndaj shqiptarëve e boshnjakëve arsyetohet me faktin se janë me shumicë myslimanë, pra si ish pushtuesi osman. Ama me këtë kriter Serbia do të duhej të luftonte edhe kundër popujve të tjerë me shumicë myslimane, që nga egjiptianët, pakistanezët, indonezianët, rohinjat etj., meqë edhe ata janë me shumicë myslimanë. Por në rastin shqiptar motivi i vërtetë është se ata jetojnë në hapësirën të cilën serbët e konsiderojnë “hapësirë jetësore” të veten, me çka ata e kanë praktikuar doktrinën “Lebensraum” para Hitlerit. Hakmarrja për Kosovën është në themelin e ideologjisë së projektit “Serbia e Madhe” edhe në ditët tona. E kamuflluar vitet e fundit si “bota serbe”, në fakt është e njëjta ideologji, por e kamuflluar pas disfatave që ka përjetuar projekti i Serbisë së Madhe në vitet nëntëdhjetë në luftërat në Slloveni, në Kroaci, në Bosnjë e Hercegovinë dhe në Kosovë. Të gjitha këto të vërteta dihen. Pse fshihen? E kuptoj pse fshihen nga serbët. Nuk arrij ta kuptoj kurrqysh pse fshihen edhe nga studiuesit shqiptarët, veçmas nga albanologët. Nëse është në themel të kësaj fshehjeje të fakteve kompleksi i inferioritetit, gjë që ka mundësi, njerëzit duhet ta dinë se kompleksi i inferioritetit nuk ka vetëm veti bllokuese po ka edhe potenciale vetë shkatërruese.

Njya e Gordit: “Kosovski srbi” apo albanofonët e serbizuar

Më duket se mënyra më e mirë për të kërkuar daljen nga ky vetë bllokim, si pasojë e kompleksit të inferioritetit përballë Serbisë, ose edhe e mercenarisë pseudoshkencore, është nëse fillojmë ta kërkojmë një zgjidhje ndërdisiplinare e humane, duke u marrë me serbët e Kosovës, si një subjekt që i përket vetë Kosovës. Nëse trajtohen si kolonë e pestë e Serbisë, kurrë zgjidhje nuk do të ketë. Është e pakuptueshme përse historiografia shqiptare e ka injoruar dhe vazhdon ta injorojë këtë çështje, e cila për Kosovën është ekzistenciale. Injorimi i problemit të serbëve të Kosovës, si nga shkencat albanologjike si nga politika shtetërore është absurd, e pakta për këto dy arsye. E para, për faktet historike që janë kokëforta dhe dëshmojnë për një prezencë disa shekullore të serbëve në truallin e Kosovës dhe e dyta, për shkak të potencialeve destabilizuese që realisht i kanë serbët e Kosovës, meqë janë të sponsorizuar direkt nga Serbia dhe në prapavijë edhe nga Rusia. Kosova me statusin e saj të pafinalizuar dhe me fuqinë e pakët ekonomike, kulturore e ushtarake, nuk ka mundësi t’i pacifikojë. Prandaj, duhet të kërkojmë rrugë më të buta të qetësisimit dhe integritetit të tyre. Mund të fillohet nga rishikimi i fakteve historike. Nga burimet historike është e dëshmuar se e pakta nga viti 1190 Kosova ka qenë e pushtuar dhe e sunduar nga nemanjidët. Pushtimi ka sjellë edhe elementin serb nga viset e tjera dhe në anën tjetër e ka rritur korpusin demografik serb me anën e asimilimit të popullsisë vendase, albanofone. Bile, serbët e Kosovës me shumicë kanë prejardhje arbërore, por që janë asimiluar nga ndikimi që ka pasur Kisha Ortodokse Serbe në kohën osmane dhe nga administrata shtetërore serbe pas pushtimit serb të vitit 1912. Për asimilimin e arbërve në serbë flasin shumë autorë, ndër ta edhe Noel Malkolmi. Ndërsa në një përshkrim nga vendi i ngjarjes, nga Kosova, Edit Durham në vitin 1908 skicon dukurinë e asimilimit të albanofonëve në serbë me këto fjale: “...ndërsa shqiptarët janë pothuajse vetëm albanofonë, sllavët e shpërndarë zakonisht i flasin të dyja gjuhët dhe kur iu flet në serbisht shpesh ta kthejnë fillimisht në shqip”. Pra, serbët e Kosovës në fillim të shekullit XX ishin edhe albanofonë dhe vetëm pas pushtimit serb të vitit 1912 ata janë sllavizuar plotësisht. Meqë gjuha e administratës ishte osmane e

jo shqipe, meqë gjuha e kishës ishte sllave e jo shqipe, ata nuk kanë pasur asnjë arsye politike, ekonomike a fetare, që ta mësonin shqipen. Ata e kanë ditur shqipen, sepse kanë pasur prejardhje shqiptare. Bile Edit Durham sjell edhe shembullin e një popi në manastirin e Deviqit, i cili i kishte treguar asaj se prindërit i kishte pasur shqiptar, por ishte serbizuar, duke shërbyer në kishën serbe. Natyrisht, ato procese duhet të studiohen, por indikacionet e shumta dëshmojnë se serbët e Kosovës, raja, (pra jo kolonistët e vonë) me shumicë kanë qenë albanofonë, që janë asimiluar në serbë. (Burimet e shumta vërtetojnë se ai proces i asimilimit të shqiptarëve në serbë ka qenë alarmant, po është ndërprerë me ardhjen e sundimit osman në këto hapësira.) Nëse shkenca do të kontribuonte në ndriçimin e të vërtetës për sa u tha, do të mund të hapej një perspektivë krejt e re për identitetin e serbëve të Kosovës, për Kishën e tyre dhe për rolin e tyre në shtetin e Kosovës, si faktor integruar. Pastaj do të mund të reflektonte edhe në sjelljet e tyre më lojale ndaj shtetit të Kosovës në kohën tonë.

Millan Radojçiqi është një kopje e Sholleviçit

Kështu si janë sot, pra edhe pa perspektivën historike, serbët e Kosovës kanë potencial destabilizues e minues ndaj shtetit të Kosovës, meqë e kanë ndihmën e pakursyer të Serbisë në prapavijë edhe të Ruisë. Me aranzhmanet e reja që ka pranuar qeveria e Kosovës, duke e pranuar Planin franko-gjerman dhe Planin e Zbatimit, serbëve të Kosovës u është ofruar autonomi politike e territoriale (Asociacioni), autonomi funksionale (për Kishën Ortodokse Serbe) autonomi kulturore dhe autonomi personale. Kjo zgjidhje e autonomisë p e r s o n a l e (V E T Ë - MENAXHIMI) i bën subjekt mbikushtetues, sepse janë të mbrojtur nga ligji vetëm për faktin se janë serbë. Ata që mendojnë se çështja e serbëve të Kosovës mbyllet me inkursione të njëjësive speciale në veri, ose janë aventurierë ose budallenj. Kjo çështje nuk mund të mbyllet, kjo çështje duhet të zgjidhet. Ja edhe një arsye nga historia e para disa decenieve, pse nuk mund të mbyllet pa u zgjidhur. Në vitet tetëdhjetë, kur filloi realizimi i projektit memorandumit serb për “Serbinë e Madhe”, roli i serbëve të Kosovës për destabilizimin e Jugosllavisë ka qenë shumë i madh. Të kapur nga shërbimet sekrete serbe dhe të futur nën diktatin ideologjik të Dobrica Qosiqit e të Sllobodan Millosheviçit, serbët e

Kosovës janë përdorur si boks hekuri për të goditur udhëheqjet politike në Kosovë, në Vojvodinë, në Malin e Zi madje edhe në vetë Serbinë (rrëzimi i Ivan Stambolliçit e Dragisha Pavloviçit.) Ideologu i nazifashizmit serb, Dobrica Qosiqi ka publikuar takimet që ka pasur me Bogdan Kecmanin e Sholleviçin dhe udhëzimet që ua ka dhënë se si të udhëhiqnin luftën e tyre për kauzën e nazifashizmit serbomadhi. Ngritja e Millosheviçit si një lider nationalist gjithë serb, filloi nga një miting në Fushë Kosovë. Histeria antishqiptare u ngrit në kulminacion në Serbi nga keqpërdorimi që u bë një akti pederastie të Gjorgje Martinoviçit në një fshat të komunës së Gjilanit. Poeti kombëtar serb, Antonie Isakoviç, e pati quajtur Martinoviçin “Jasenovc për një njeri”, duke e krahasuar me kampin e përqendrimit. Një grua serbe e një fshati të Istogut, e fotografuar me kallashnikov se gjoja po e mbronte pronën, u shndërrua në personazh për mobilizim e militarizim antishqiptar në Serbi. Bandat e sotme në veriun e Kosovës kanë vazhdimësi nga ato projekte e nga ato keqpërdorime që u bëhen serbëve të Kosovës nga shteti serb. Millan Radojçiqi është një kopje e Sholleviçit. Nesër do të mund të jetë një Radojçiqi tjetër edhe më brutal. Në një version paksa patetik, mund të jetë që atentatori Millosh Obiliç, të jetë shëmbëlltyra e ekstremistëve serbë të Kosovës, në stilin e vargut popullor, “e vras veten t’faroj ty.” Gjendja e pezullt e serbëve të Kosovës dhe fuqia e Serbisë që t’i sponsorizojë projektet e tyre irredentiste, do t’i prodhojë në mënyrë serike personazhet e tipit të Millosh Obiliçit, Sholleviçit e Radojçiqit, deri sa serbët e Kosovës të rehabilitohen e të integrohen në shtetin e ri. Ata janë nxjerrë nga shteti kombëtar i tyre, nga Serbia dhe ende nuk janë pajtuar me atë ndryshim, i cili prej tyre përjetohet si kërcënim identitar, ndonëse në esencë është ndryshim gjeopolitik. Konkludimi im është se me qasjet që kemi, duke mos e rishikuar të kaluarën, duke mos u përballë me realitetin ose duke bërë ndërhyrje policore parciais, nuk ka zgjidhje të qëndrueshme. Ndërsa pa e zgjidhur problemin e serbëve të Kosovës, në favor të shtetit të Kosovës, duke e siguruar lojalitetin e tyre, nuk mund të largohet influenca malinje e Serbisë e Ruisë. Nuk mund të ketë Kosovë të qetë e demokratike. Rrjedhimisht as Ballkan të qetë e evropian.

Loja me “Klan Kosovën”, aferat korruptive, dorëzimi dhe poshtërimi në veri të Kosovës!



Shkruan: Behxhet
Sh. SHALA - BAJGORA

Qytetarët e Kosovës kohën e fundit ishin shikues të hutuar të një shfaqjeje të stisur dhe të menaxhuar mirë: “përpjekjes” së pushtetit për ta mbyllur “Klan Kosovën” e që automatikisht “ngjalli” veprimin opozitar, të shoqërisë civile dhe institucioneve vendore dhe ndërkombëtarëve për mbrojtje të lirisë së medieeve. Domosdoshmërisht edhe të Flutura Kusarit. E tërë kjo u bë me MINT-in si ekzekutor i një vendimi më lart, mbase nga kreu. Unë në asnjë çast nuk isha i bindur se “Klan Kosova” mund të mbyllet sepse pozita në tërë dimensionin e papërgjegjesisë, arrogancës, mungesës së transparencës dhe llogaridhënies nuk është aq e marrë ta bëjë këtë veprim që do t’i kthehej si bumerang me një kosto shumë më të lartë se që do të ishte investimi. Aferat ku dyshohet se mund të ketë pasur korupsion të lartë, sidomos në MINT, u zhvendosën nën mirzin e heshtjes duke e plasur një bombë siç ishte “mbyllja” e “Klan Kosovës”. Dhe e tëra kjo përfundon me vendimin e Gjykatës Komerciale që, me një infuzion juridik, e lë çështjen hapur duke ia “zgjatur” jetën “Klan Kosovës”. Prandaj, pa asnjë dyshim konsideroj çështjen e “Klan Kosovës” të mbyllur nga e cila kanë përfutur të gjitha palët; pozita kinse po ushtron zbatim të ligjit përmes një patriotizmi folklorik, opozita e defaktorizuar kinse po vdesë për liri të medieeve, shoqëria civile kinse po vdesë për mbrojtje të demokracisë, ndërkombëtarët që po na fusin kepën në veri tash po i mbrojnë mediet nga pozita që është partner aktiv i ndërkombëtarëve që, përmes përshkallëzimit të rremë në veri të Kosovës t’i realizojë projektet e dëmshme politike për Kosovën që i garanton pushtet, ndonëse deri në fyt janë zhytur në parregullsi, nepotizëm, klientelizëm,

korupsion dhe shkelje të Kushtetutës. Tash, në një mjedis krejtësisht jotransparent, persona të papërgjegjshëm dhe të paafte profesionalisht për bisedime, mashtrues dhe injorantë ordinerë bëjnë marrëveshje për depërshkallëzim duke dhunuar ligjet dhe Kushtetutën e vendit. Para se të shpallehin zgjedhjet lokale në katër komunat në veri të Kosovës, kishte rekomandime nga organizatat që kanë ekspertizë për zgjedhje se në rrethanat e krijuar nuk ka kushte për organizim të zgjedhjeve nga të cilat do të del një përfaqësim legjitim dhe i pranueshëm për shumicën e votuesve – qytetarëve të Kosovës. Institucionet e Kosovës i shpallën këto zgjedhje që u bojkotuan nga 95 për qind e votuesve, i pranuan rezultatet e zgjedhjeve sikur që trimëruan “kryetarët” e zgjedhur të qëndrojnë dhe punojnë në zyra të cilat, fillimisht ruheshin nga Njësia Speciale e Policisë së Kosovës e pastaj nga KFOR-i që e rriti praninë duke marrë edhe kompetenca policore. Tash, pas tërheqjes së Policisë së Kosovës nga objektet e komunave në veri të Kosovës, herë flitet për 25%, pastaj për 50% (askush nuk e di numrin e saktë të policëve të tërhequr) ndërsa kushti i serbëve është që të tërhiqen të gjithë, EULEX-i ka marrë përgjegjësi absolute për sigurinë duke e zhvendosur dhe defaktorizuar policinë e Kosovës, deri në përjashtim dhe shpërfillje, në emër të Marrëveshjes së Bratisllavës e nënshkruar nga mashtruesi i Muçiverces. Ministrat mashtrues që trimëronin “kryetarët” e komunave në veri të qëndrojnë në zyra dhe të punojnë në përputhje me “mandatin”, tash, pa asnjë fije turpi dhe përgjegjësie institucionale, profesionale dhe personale, po kërkojnë mënyra që t’i deligjitojnë, qoftë përmes shkarkimit me një Udhëzim Administrativ (pse të shkarkohen), qoftë duke i detyruar të japin dorëheqje. Në të njëjtën mënyrë po veprojnë edhe me Policinë e Kosovës. Minimumi i ndershmërisë profesionale, institucionale dhe personale, hiç këtu atë morale që është e panjohur do të duhej t’i detyronte që ta pranonin se problemi e kanë shkaktuar vet, se problemi është krejtësisht i

natyrës politike dhe ashtu duhet edhe ta zgjidhin! Tash, një ministër tipik bedel, Faraoni i Pushtetit Lokal, Elber Krasniqja nuk po hapë shtigje për të qëndruar, shkuar para, për ta shtrirë sovranitetin por si ta ruaj prapancën e vet duke i turpëruar katër kryetarët e komunave të veriut të Kosovës. Ku është marrja për këtë zbythje: Atiqi i LV-së u tregua më ambiciozi duke shpalosur plane që asnjë kryetar i zgjedhur në mënyrë të rregullt dhe për dy mandate nuk do të kishte mundësi t’i realizonte. Bëri kërkesë për anëtarësim në Asociacionin e Komunave të Kosovës dhe këtë kërkesë faraoni i pushtetit lokal, në rastin më të mirë mund ta përdorë për qëllime higjienike. Shkuan ministra për ta vizituar madje edhe duke e rrezikuar jetën edhe Atiqin edhe Lulin - Oso Kukën e Leposaviqit (fshat afër Vraninës) për t’iu dhënë zemër që nuk e kishin as për vete, u përzënë nga ushtarët e KFOR-it por ua dërguan porosinë e shefit nr.1, Albin Kurtit, kryeministrit dhe shefit nr. 2 Babushka ideologjike e LV-së, me prejardhje nga andartët grekë. Në kohën kur Atiqi vepronte si telefon mobil duke lëvizur në përputhje sa kishte qasje në rrjet, Oso Kuka i Leposaviqit u ngujua në komunën e Leposaviqit ku priste palë, ministra, deputetë apo postonte në rrjete sociale për gjininë e bukur dhe afinitetet e gastronomisë. Këta të PDK-së, Zeqiri dhe Peci u takuan me ambasadorin amerikan dhe pranuan të punojnë edhe në zyrat e Madagaskarit, por jo edhe në zyrat komunale. I pranuan kushtet e ambasadorit, ndërsa këta të LV-së si koçëmëdhjenj që janë nuk gjetën kohë as për ta takuar ambasadorin amerikan, thjesht deklaruan se ishin të zënë me punë tjera. Realisht, për persona të përgjegjshëm në komuna ka shumë punë e sidomos muajve të verës kur diaspora kthehet në Kosovë për pushime. Këta të LV-së nuk e dinë çka është dorëheqja, as si akt moral e as si detyrim ligjor përveç nëse ua kërkojnë këtë shefat, Albini dhe Babushka ideologjike. E duket se do ua kërkojnë, jo drejtpërdrejtë por përmes faraonit të pushtetit lokal i cili, ndonëse është analfabet politik paska filluar ta shkruaj një Udhëzim Administrativ me të cilin do t’i

shkarkojë këta kryetarë që aq shumë punuan këta muaj. Për Atiqin nuk paraqet asnjë problem sepse përshtatet në të gjitha regjimet mirëpo, për Oso Kukën është një fund i palavdishëm, madje edhe turpëruar; mund të qëndrojë edhe më shumë se 100 ditë i ngujuar në Komunën e Leposaviqit, i gatshëm për sakrificë që do t’ia kalonte edhe origjinalit Oso Kukës në Kullën e Vraninës për t’u detyruar t’i mbledhë plaçkat në bazë të një cope letre e nënshkruar nga një bedel siç është faraoni. Këta të PDK-së po tregohen bashkëpunues, Zeqiri deklaroi se mund të dorëhiqet pa asnjë problem, kurse Peci për dallim nga ai Peci tjetër po del të jetë fort i vendosur; pa marrëveshje politike, nuk ka dorëheqje. Shumë analistë dhe humbëskeho po deklarohen se dorëheqja është zgjedhja dhe zgjidhja më e mirë dhe më e lehtë, sigurisht më e lehtë, për të shkuar në zgjedhje tjera ku Lista Serbe do të rikthehet në pushtet. Lista Serbe u ftua në Uashington në takim me zyrtarët amerikanë kurse “serbët e Kurtit”, Rashiçi dhe Trajkoviçka po ua mbajnë zhagun deklarimeve të Petkoviçit dhe të Vulinit. Këta që po i detyrojnë kryetarët e komunave të tërhiqen apo të shkarkohen janë pa pikë fytyre sepse vet i futën në zjarr. Kryetarët që do të pranohen të deligjitoohen me një copë letre apo duke iu nënshtruar presionit, nuk meritojnë trajtim më të mirë. Të gjithë po e kërkojnë dhe pëlqojnë rugën më të lehtë edhe për të qëndruar në pushtet edhe për të ardhur në pushtet. Në këtë kontekst, opozita ka luajtur që nga fillimi në kartë të djegur se Albin Kurti do të refuzojë çdo marrëveshje prandaj do të detyrohet të jep dorëheqje ose do të shkarkohet nga ndërkombëtarët. Prej fillimi kam shkruar se Albin Kurti kurrë nuk do të jep dorëheqje aq më parë që nuk ka lënë mënyrë pa përdorur për të ardhur në pushtet. Dhe, dihet mirëfilli se dikush që përdorë aq shumë mund për të ardhur në pushtet, nuk do të lë mënyrë apo mjet për të përdorur për të mbetur në pushtet. Prandaj është i rrethuar me mediokër dhe injorantë, me të tillë që asgjë nuk kanë bërë personalisht dhe familjarisht as për Kosovën e as për shqiptarët. Përkundrazi, vet dhe familjarisht

qençe i kanë shërbyer Jugosllavisë dhe Serbisë, edhe më qençe i shërbejnë sot të gjithë atyre që ua mundësojnë të mbesin në pushtet. Kosovës i duhet një unitet dhe pajtueshmëri midis subjekteve politike, jo për të arritur një marrëveshje të mirë me Serbinë, por që të sigurohemi se humbjet do të jenë sa më të vogla dhe sa më të përbalueshme. Të menaxhohet një humbje e pashmangshme ku veriu i Kosovës vetëm formalisht do të jetë brenda Kosovës kurse me mendje, shpirt dhe veprim do të jetë i orientuar kah Beogradi. Kosova ka nevojë për politikanë që jetojnë, veprojnë dhe perspektivën personale dhe familjare e kërkojnë dhe e gjejnë në Kosovë. Kosova nuk ka nevojë për qeveri të baustellës që në Kosovë vetëm e bëjnë gjumin dhe e mbushin xhirollogarinë kurse familjen dhe ardhmërinë e kanë në shtetet tjera. Këta, në fakt asnjë cilësi në qeverisje nuk ia kanë sjellë Kosovës për faktin se kanë ardhur sipas linjave të klanit dhe nepotizmit. Kurrë Kosova nuk ka pasur ministra më të padijshëm, më mediokër dhe më të papërgjegjshëm se që i ka tani. Kurrë Kosova nuk ka pasur deputetë më të papërgjegjshëm, më të padisiplinuar dhe më të dobët intelektualisht se që janë tani prandaj e kemi një Kuvend si e kemi. Edhe Kuvendi i Hajkobillës është më profesional dhe më i përgjegjshëm. Me zbythjen e turpshme në veri të Kosovës, me mungesën e gatishmërisë për bashkëpunim midis pozitës dhe opozitës, me një qeveri të baustellës dhe me një Kuvend shumë nën nivelin e Kuvendit të Hajkobillës, Kosova si shtet ka gjasë të ikën përlesh. Kosova ka mungesë të autoritetit moral dhe politik që do të pranohej nga të gjithë apo, së paku nga shumica. Të tillë sot nuk ka. Para se të bëjë Kosova marrëveshje me Serbinë, duhet ta bëjë një marrëveshje me Shqipërinë. Para se ta bëjë Albin Kurti një marrëveshje me Vuçiqin, duhet ta bëjë një marrëveshje me Edi Ramën. Nuk ka rrugë dhe mundësi tjetër sepse Shqipëria është toka, qielli, ajri dhe uji i Kosovës! Është kusht i domosdoshëm për mbijetesë të Kosovës në të kundërtën do të shndërrohemi në një mbetje mortore të një shteti eksperimental!

Nuk i rezistoj tundimit, për të blerë libra të rinj



Nga: Jorge Luis BORGES
Përktheu: Alket ÇANI

... Për aq sa më kujtohet, grekët nuk i përdornin shumë librat. Është fakt që shumica e mendimtarëve të njerëzimit nuk i janë drejtuar shkrimit, por fjalës. Mendoni për Pitagorën, për Krishtin, për Sokratin, për Budën etj. Dhe, meqenëse përmenda Sokratin, do doja të thosha dy fjalë për Platonin. Më kujtohet që Bernard Shaw thoshte se Platonin ishte dramaturgu që kishte krijuar Sokratin, ashtu sikundër katër ungjillorët ishin dramaturgët që kishin krijuar Krishtin. Ndoshta këto shkojnë shumë larg, por ka këtu, ama, një pjesë të vërtetë. Në një nga dialogët e tij, Platonin nuk i lëvdon shumë librat: “Ç’është libri? Libri është si një tablo, ka pamje të gjallë, por nëse i bëjmë një pyetje, ai nuk na përgjigjet dhe atëherë shohim se paska qenë i vdekur.” Dhe, për të shndërruar librin në realitet të gjallë, ai shpiku, fatmirësisht për ne, dialogun platonik që u del përpara dyshimeve dhe pyetjeve të

lexuesit.


Por, do mund të thoshim gjithashtu që Platonin kishte nostalgjinë e Sokratit. Pas vdekjes së Sokratit, ai me siguri thoshte shpesh me vete: “Ç’do kish thënë Sokrati rreth kësaj pike për të cilën kam dyshime?” Atëherë, për të dëgjuar sërish zërin e mjeshtrit të dashur, ai shkroi dialogët. Në disa dialogë, Sokrati përfaqëson të vërtetën, të vërtetën e pakundërshtueshme. Në të tjerë, Platonin ka vënë në skenë gjendjet e tij të ndryshueshme e të shumëfishta shpirtërore. Disa nga dialogët nuk dalin në asnjë përfundim sepse Platonin, duke i shkruar, vazhdonte të reflektonte: nuk e dinte cila do ishte faqja e fundit në çastin kur shkroi të parën. Ai e linte mendjen të bredhërinte dhe këto bredhëritje mishëroheshin në personazhet e ndryshëm të dialogut të tij. Ma merr mendja se objektivi i tij kryesor ishte t’i ofronte vetes iluzionin se, përtej faktit që Sokrati kishte pirë helmin, ky i fundit ishte përherë pranë Platonit. E kam këtë bindje, ngaqë kam pasur shumë mjeshtra në jetë. Jam

krenar që jam dishepull dhe, shpresoj, një dishepull i mirë. Mirëpo, kur mendoj për tim atë, kur mendoj për shkrimtarin e madh judeo-spanjoll Rafael Cansinos Asséns, kur mendoj për Macedonio Fernándezin, do doja të dëgjoja edhe zërin e tyre. Nganjëherë ushtrohem duke imituar zërat e tyre: shpresoj gjithashtu të mund të mendoj siç mendonin ata. Janë gjithmonë pranë meje. Te njëri nga etërit e Kishës ka një fjali që thotë se është po aq e rrezikshme të vësh një libër në duart e një injoranti, sa të vësh një shpatë në duart e një fëmije. Kjo sepse, për antikët, librat nuk ishin tjetër veçse një mjet. Në një nga letrat e tij, Seneka ngrihet kundër bibliotekave të mëdha. Shumë kohë më vonë, Schopenhauer ka shkruar se shumë njerëz bënin gabimin të besonin se duke blerë një libër, blenin gjithashtu edhe përmbajtjen e librit. Më ndodh ndonjëherë t’i hedh sytë mbi librat e shumë të kam në shtëpi dhe të them me vete se do vdes para se t’i kem lexuar të gjithë. E prapëseprapë nuk i rezistoj dot tundimit për të

blerë gjithmonë libra të rinj. Sa herë që hyj në një librari e që bie mbi ndonjë vepër që ka lidhje me ndonjë nga temat e mia të preferuara – për shembull poezi në anglishten e vjetër apo norvegjishten e vjetër – them me vete: “Sa keq që s’mund ta blej këtë libër, ngaqë e kam tashmë një ksombël në shtëpi.” Më vonë – e kam fjalën, pas antikëve – një konceptim i ndryshëm i librit na erdhi nga Lindja: ideja e një Shkrimi të shenjtë, e librave të shkruar nga Shpirti i Shenjtë. Atëherë u shfaqën Kurani, Bibla dhe të tjerë. Do doja të frymëzohesha nga Spengler- i, nga “Rënia e Perëndimit” të tij, e të merrja Kuratin si shembull. Nëse nuk gabohem, teologët myslimanë e mbajnë Kuratin si të krijuar përpara krijimit të fjalës. Kurani është shkruar në arabisht e megjithatë myslimanët e konsiderojnë si ekzistues përpara gjuhës. Madje, kam lexuar diku që ata mendojnë se Kurani nuk është një vepër, por një atribut i Zotit, siç është Drejtësia, Dhembshuria apo Urtësia e Tij. Kështu ndodhi që Europa

njohu idenë e një Shkrimi të Shenjtë dhe kjo ide, për mendimin tim, nuk është krejtësisht e gabuar. E pyetën një ditë Bernard Shaw-n (tek i cili rikthehem shpesh) nëse vërtet mendonte se Bibla ishte vepër e Shpirtit të Shenjtë. Dhe përgjigja e tij ishte: “Besoj se Shpirti i Shenjtë nuk ka shkruar vetëm Biblën, por të gjithë librat.” Sigurisht që kjo përgjigje ka diçka dërrmuese për Shpirtin e Shenjtë – por ma merr mendja se gjithë librat e meritonjë të lexohen. A nuk ishte e njëjta gjë që donte të thoshte Homeri kur i drejtohej Muzës? Apo që donin të thoshin hebrejtë dhe Milton-i kur flisnin për Shpirtin e Shenjtë, tempulli i të cilit është zemra e dëlirë e njerëzve? Në mitologjinë tonë të sotme, jo aq të bukur, flasim për një “un të nënvetëdijshëm” dhe për “nënvetëdijen”. Këto janë terma paksa të vrazhdë nëse i krahasojmë me Shpirtin e Shenjtë apo me Muzën. Por duhet të përshtatem me mitologjinë e kohës. Në fund të fundit, të gjitha këto fjalë kanë të njëjtin kuptim ...

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Envert
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



Ramadani: Do ta jap shpirtin për këtë fanellë

LECCE, 4 GUSHT - Reprerentuesi i Kombëtares së Shqipërisë në futboll, Ylber Ramadani, është paraqitur te skuadra e Lecces në Itali. Futbollisti nga Kosova u largua nga

Aberdeeni dhe tash do të nisë një aventurë të re në karrierën e tij futbollistike, derisa klubi italian pagoi 1.2 milion euro për mesfushorin kuqez. "Jam mjaft i lumtur që do ta nis

këtë përvojë të re në një klub të madh si Lecce. Mezi pres ta jap shpirtin tim për këtë fanellë. Faleminderit të gjithëve dhe menaxherit tim Shkumbin Qormemeti dhe

SSM Agency!", ka thënë Ramadani. 27-vjeçari gjatë karrierës së tij ka luajtur për Ferizajn, Prishtinën, Dritën, Partizanin, Vejle BK, MTK Budapest dhe Aberdeen.



Sonte beteja kryesore e Kosovës



EPOKA E RE

Veton ZYMBERI

Prishtinë, 4 gusht - Përfaqësuesja e Kosovës në basketboll sonte (e shtunë) e zhvillon njërën prej ndeshjeve më të rëndësishme në historinë e saj. Kundërshtarë e "dardanëve" në palestrën "Sezai Surroi" në Prizren është Kombëtarja e Danimarkës dhe kjo përballje do të përcaktojë se cili shtet do të sigurojë një vend në kualifikimet e "Eurobasket 2025". Ky është Rrethi i Tretë Parakualifikues, ku në grup ishte edhe Zvicra, që pësoi katër

humbje, derisa Danimarka ka shënuar tri fitore, derisa Kosova ka dy fitore e një humbje. Ndeshjen e parë e fituan danezët me rezultat 82:75, kurse Kosovës i duhet një fitore me shtatë pikë epërsi. Kapiteni i Kosovës, Dardan Berisha, ka kërkuar mbështetje nga tifozët për ndeshjen ndaj Danimarkës. "Më 5 gusht ju presim në sallë, pasi përkrahja juaj është motiv për ne", ka thënë Berisha. Në anën tjetër thirrja e Dardan Kapitit ishte: "Vetëm të bashkuar drejt fitores dhe kualifikimit". Ashtu sikurse basketbollistët e Kosovës, edhe Federata e Basketbollit ka

kërkuar përkrahje nga tifozët që të jenë në numër sa më të madh në sallë për ta përkrahur përfaqësuesen drejt ëndrrës së madhe të kualifikimit. Lista e shteteve në kualifikueset e FIBA EuroBasket 2025: Belgjika, Bosnjë-Hercegovina, Bullgaria, Kroacia, Qipro, Republika Çeke, Estonia, Finlanda, Franca, Gjeorgjia, Gjermania, Britania e Madhe, Greqia, Hungaria, Islanda, Izraeli, Italia, Letonia, Lituania, Mali i Zi, Holanda, Maqedonia e Veriut, Polonia, Portugalia, Serbia, Sllovakia, Sllovenia, Spanja, Suedia, Turqia dhe Ukraina.

Sonte përballja e shumëpritur Krasniqi - Mohammedi

"Epoka e re"

PRISHTINË, 4 GUSHT - Meçi i shumëpritur i boksit në mes të boksierit të suksesshëm shqiptar Robin Haxhi Krasniqi dhe Nadjib Mohammedi do të zhvillohet sonte (e shtunë) me fillim nga ora 18:30 në stadiumin "Fadil Vokrri". Kjo është hera e parë që boksieri nga Juniku bokson për herë të parë në vendlindje e tij, prandaj edhe përgatitjet i ka bërë speciale. Krasniqi nuk ka hezituar të bëjë një premtim të madh për tifozët shqiptarë të cilët do të ndjekin me kënaqësi të madhe të shtunën që vjen, disa mijëra në stadiumin "Fadil Vokrri" në Prishtinë e të tjerët përmes ekranit televiziv. "Ju faleminderit nga zemra të gjithëve për përkrahjen e madhe! Unë, biri yt Kosovë, do të bëj krenar vendin tim dhe do të bëj krenar më 5 gusht secilin prej jush. Ju pres që të përjetoni nga afër emocionet,

KRASNIQI VS MOHAMMEDI
18:30
05 GUSHT
STADIUMI
FADIL VOKRRI

adrenalinën dhe kënaqësinë që do të ofrojë ky event", ka thënë Krasniqi. "Jam i lumtur që boksoj në vendin tim. Normalisht ka qenë synim ky meç dhe të gjejmë një kundërshtar të fortë. Do të tregoj punën që kemi bërë muajt e fundit në përgatitje", ka shtuar Krasniqi. Në anën tjetër, kundërshtari i Krasniqit, Nadjib Mohammedi, ka bërë me dije se ka bërë përgatitje të mira për këtë meç. "Njerëzit janë shumë të mirë. Jam shumë i lumtur që jam këtu për meçin. Faleminderit shumë për këtë mundësi të madhe! Jam shumë i gatshëm dhe ndihem perfekt. Jam përgatitur mjaft mirë. Kam udhëtuar në Francë, Spanjë dhe disa shtete të tjera. Kam pas 'sparing' për këtë meç dhe gjithçka është në rregull. Pres që mbështetësit e mi të më përkrahin. Ju dëshiroj të më shihni mua të fitoj tituj. Ju më përkrahni, më shtyni mua dhe unë e vlerësoj këtë gjë", ka thënë Mohammedi.

Shtyhet afati kalimtar në basketboll

Prishtinë, 4 gusht - Afati kalimtar i transferimeve në basketbollin e Kosovës është dashur të përfundojë të premtën, por Federata e Basketbollit e Kosovës ka

vendosur që ky afat të shtyhet deri më 11 gusht. "Bordi i Federatës së Basketbollit të Kosovës (FBK) më 4 gusht, pas shqyrtimit të kërkesave të

disa klubeve të FBK-së, ka marrë vendim për shtyrjen e afatit kalimtar për lojtarë/e vendorë/e dhe të huaj/a. Përderisa afati kalimtar është dashur të

përfundojë të premtën, është vendosur që po i njëjti të shtyhet deri më 11 gusht 2023. Vendimi hyn në fuqi menjëherë", thuhet në njoftimin e FBK-së.



Vidhet shtëpia e Zenelit dhe Berishës, dëmi rreth 350 mijë euro

Reims, 4 gusht - Dy futbollistët kosovarë Arbër Zeneli dhe Valon Berisha janë grabitur të mërkurën teksa udhëtonin për Stade de

Reims. Shtëpia e dy futbollistëve nga Reimsi u grabit gjatë një udhëtimi me klubin. Sipas prokurorit të Reimsit, dëmi vlerësohet

midis 300 mijë dhe 350 mijë euro. Dy lojtarët po udhëtonin me ekipin rezervë në Valenciennes në momentin e ngjarjes, në pasditen e së

mërkurës. Sipas konstatimeve të para, janë vjedhur dy çanta Louis Vuitton dhe shtatë ora Rolex, me një vlerë totale nga 300 000 deri në 350 000 euro.



Federeri rrëfen jetën pas tenisit: Jam duke bërë gjëra që dikur ishin të porealizueshme për mua

NJU-JORK, 4 GUSHT - Ka kaluar thuasjse një vit qëkur Roger Federeri njoftoi tërheqjen e tij nga sporti, duke i dhënë vetes kohë të përgatitjes edhe për ndeshjen e tij të fundit në karrierë, në turneun e Laver Cup. Një ndeshje në lojën dyshe me mikun dhe rivalin e tij Rafael Nadal. Ish-tenisti zviceran ka qenë së fundi në Nju-Jork, ku ka dhënë një intervistë. Fituesi i 20 grand slameve iu rikthye ndjesive që përjetoi pas lamtumirës së tenisit. "Jeta pa tenis, jeta pa tifozët dhe jeta pa programin që ka dominuar jetën time për 25 vjet ishte padyshim diçka që nuk e dija se si do ta merrja", ka thënë Federeri. "Për një kohë të gjatë u përpoqa të kthehesha dhe t'i jepja vetes një mundësi tjetër, të largohesha shëndoshë e mirë nga ky sport, por thjesht nuk ishte e mundur. E mira dhe e keqja e Covid si dhe me operacionin tim në gju, bëri që gjithçka të ngadalësohet në



tre vitet e fundit", ka shtuar Federeri. Më tej, zvicerani shton: "Në fund, u lehtësova kur mora vendimin dhe jam i lumtur që dola në pension. Gjithçka përfundoi në mënyrë perfekte në Laver Cup. Unë isha i rrethuar nga rivalët e mi më të mëdhenj, familja dhe miqtë e mi. Për mua ishte si "OK, tani jam mirë". Dalja në pension i lejoj Roger Federer t'i zgjeronte horizontet e tij, pasi një jetë e re ka nisur për tenistin zviceran.

"Po bëj gjëra që nuk ishin të realizueshme kur isha duke luajtur sepse u desh shumë kohë", ka deklaruar Federer. "Unë kam qenë gjithmonë i rreptë dhe serioz për të qenë një sportist profesionist, por do të haja hamburger, do të haja ëmbëlsira, do të pija një gotë verë. Për mua, ngrënia e një hamburgeri nuk ishte asgjë e pazakontë, por ky duhej perfekt, kështu që më duhej të postoja një foto të tij", ka shtuar tenisti zviceran.

Maignan: Nuk më zë gjumi kur Milani humbet, stërvitem edhe gjatë mbrëmjeve

MILANO, 4 GUSHT - Kuqezinjtë kanë në përbërje një ndër portierët më të mirë në planet, Mike Maignan. Francezi është një garanci mes shtyllave, por edhe një lider i skuadrës së Stefano Piolit. Në një prononcim për "ESN Talks", 28-vjeçari, i cili mban edhe pozitën e titullarit të kombëtarja e Francës, theksoi se humbjet dhe pësimi i golave e lënë pa gjumë. Maignan ka një mentalitet të hekurit dhe gjithmonë kërkon më të mirën nga vetja dhe shokët e skuadrës. "Ne të gjithë duam të bëhemi më të mirët në profesionin tonë. Ky është objektiv. Të jesh portieri më i mirë në botë për një vit është e lehtë, por jo për disa vjet radhazi. Kjo është arsyeja pse duhet të punosh shumë në aspektin mental. Skuadra ime duhet ta fitojë ndeshjen që ka, përndryshe është problem i



madh... Mua nuk më zë gjumi kur humbas ndeshjen apo kur pësoj gola. Hap kompjuterin ose iPain dhe shoh përsëritjet dhe rastet e golave. Analizoj çfarë bëra unë gabim, çfarë bëri ekipi gabim. Dhe si mund të mos e bëjmë ne atë gabim", ka thënë Maignan. "E bëj gjumin rehat vetëm kur fitojmë bindshëm dhe nuk kam pësuar gol. Zgjedhim çdo mëngjes me dëshirën për të punuar fort. Shokët e mi të

skuadrës janë kundërshtarët e mi në stërvitje. I dua shumë, por nuk dua t'i lejoj të më mposhtin. Nëse humbas në stërvitje do të thotë se diçka nuk shkon. Shpesh çohem nga krevati ose divani në orën 11 të mbrëmjes dhe iki të bëj palestër në dhomën e ushtrimeve. E di që ju duket çmenduri, por për mua është normalitet. Lajme nuk lexoj, me vijnë ndonjëherë njoftime mbi emrin tim: a jam më i miri apo janë të tjerët më të mirët. S'më intereson fare, për mua puna vijon njësoj. Brenda meje e di kush jam. Nëse mbrojtja ka gabuar, unë u flas dhe i them se si duhet ta kishin bërë. Shoh të gjithë fushën për të kuptuar se cila mund të jetë zgjidhja. Me duhen 2-3 sekonda për të marrë një vendim kur kam topin", ka shtuar "gardiani" i Milanit.

SHKURT

Berisha kërkohet nga Pirlo

Teksa është jashtë fushave të blerta prej më shumë se një viti, "gardiani" i portës së Kombëtares shqiptare, Etrit Berisha, është pranë largimit nga "demat" e Torinos, teksa po kërkon prej disa javësh një "aventurë" të re. Sipas raportimeve më të fundit nga mediet italiane, Berisha lidhet me një kalim te klubi i Sampdorias në Serinë B, me teknikun Andrea Pirlo, që kërkon personalisht shërbimet e "shtatlartit" shqiptar në skuadrën e tij. Mirëpo, duket se jo çdo gjë shkon "vaj", pasi problem mbetet paga e lartë e lojtarit dhe Sampdoria do të ishte në gjendje ta përballonte Berishën vetëm në rast se Torino do të paguante një pjesë të rrogës së "legjionarit".

Disasi, lojtar i ri i Chelseat

Axel Disasi është futbollisti më i ri i skuadrës së Chelseat. Qendërbrojtësi që edicionin e fundit ishte pjesë e Monacos pritet të nënshkruajë një kontratë 5-vjeçare me Chelsean. 25-vjeçar i mbrojtjes u kushtoi londinezëve plot 45 milionë euro dhe pritet të jetë një ndër lojtarët kyç në vijën e fundit të mbrojtjes, teksa pëlqehet shumë nga tekniku argjentinas Maurizio Pochettino.

Pensionohet Soldado

Roberto Soldado është pensionuar nga futbolli, pasi u lirua nga klubi i tij i fundit Levante. Gjatë karrierës së tij sulmuesi ka luajtur për Real Madridin, Osasunan, Getafen, Valencian, Villarrealin dhe Granadan, me periudhën e tij në Los Che më të suksesshme. Kjo i dha atij një transferim prej 30 milionë eurosh në Tottenham Hotspur. Soldado, gjithashtu, kaloi edhe dy vjet në Turqi me Fenerbahçen. Për Spanjën, ai zhvilloi 12 paraqitje dhe shënoi 7 gola, megjithëse nuk bëri kurrë një turne të madh. Në total Soldado bëri 610 paraqitje, duke shënuar 224 gola dhe duke asistuar në 74 raste.

Kessie arrin marrëveshje me Al-Ahlin

Futbollisti nga Bregu u Fildishtë, Franck Kessie, do të largohet nga La Liga. Ai tashmë ka arritur marrëveshje me klubin e Al-Ahilit nga Arabia Saudite. Gazetari italian Fabrizio Romano raporton se 26-vjeçari ka arritur marrëveshje me klubin arab dhe do të largohet nga Barcelona. Kessie ka kontratë me Barçën deri në vitin 2026, por dëshiron një aventurë të re në Shtetet Arabe, kurse Al Ahli për Kessien do të paguajë rreth 15 milionë euro. Kujtojmë që skuadra arabe deri tani ka transferuar futbollistët Mahrez, Firmino, Mendy dhe Allan Saint-Maximin.

Enrique nuk mendon të largohet nga PSG-ja

Trajneri Luis Enrique ka reaguar pas zërave të një dite më parë se mund të lërë ekipin e PSG-së. Përmes rrjeteve sociale ai ka postuar

dy foto nga puna e tij e përditshme me skuadrën parisiene. Në foton e parë ai duket i ulur mbi një top në mesin e fushës, në foton e

dytë ai është duke bashkëbiseduar me stafin e tij. Kjo foto është e shoqëruar edhe nga një koment: "Të gjithë për një, një për të

gjithë". Pra, duket se retë e zeza të shfaqura një ditë më parë janë larguar dhe se puna vijon normalisht te skuadra parisiene. Duket se një epokë

e re do të nisë te PSG-ja, që së fundi po mbyll marrëveshjen për të sjellë në Paris sulmuesin portugez Gonçalo Ramos.



BUKURISË

Sa vjet, kishim së bashku motra ynë.

Shkuat në kopshtin e bukur, ashtu siç keni qenë shpirtërisht e bukur por gjithmonë do të qëndroni në zemrat tona.

Hapat tuaj të bardhë, çdo gjë në perla do t'i mbajmë edhe atë përgjithmonë që pasqyra juaj në bardhësi jo vetëm tek burri por edhe në vajzërisë e të njëjtën pasqyrë mbanë Agnesa me plotë burrëri edhe ashtu siç keni dëshiruar.

Motra ime, pesëdhjetë vjet e kishit një kujdes diamanti edhe për mua si për të tjerët në familje dytësore që nga dashuria juaj së bashku me Nesën do të vazhdojmë lindje madhështore për të shkrirë çdo gjë që na vjen për dore .

Nga: Violeta GASHI

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 08/L-181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 16, pika 4, Kompania "Edmond A. Hasani" BI, Vushtrri, në bashkëpunim me Ministrin e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe komunën organizojnë:

DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për "Edmond A. Hasani" BI, Stacioni i Karburanteve në Vushtrri

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 15.09.2023 në ora 11:00 në Shkollë "Ali Kelmendi" rr. Ajet Gerguri - Vushtrri, do të organizohet debat publik nga Kompania "Edmond A. Hasani" BI, Stacioni i Karburanteve në Vushtrri, në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe Komunën.

Debati Publik do të organizohet edhe në mënyrë virtuale në platformën ZOOM

Zoom:

Join Zoom Meeting

<https://us05web.zoom.us/j/85836248083?pwd=IvwuGv5kyeXbpF7M1wIsLYFJCFskbT.1>

Meeting ID: 858 3624 8083


Passcode: 8qh9Q3

Në linkun e mëposhtëm mund të gjeni raportin e VNM-së për kompaninë "Edmond A. Hasani" BI, Stacioni i Karburanteve në Vushtrri

<https://mmphi.rks-gov.net/Document/Announcements?type=2>

Në emalin e mëposhtëm mund të dërgoni komentet lidhur me projektin vnk.komente@rks-gov.net

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon në implementimin e projektit.



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punës
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook

www.facebook.com/gjejpuneshpejte

RESTAURANT

SWISS TAVERNA

Tel: +377 45 400 156

+386 49 848 553

PRISHTINË

Lumë's Details
Estetik & Depilim

044 900 978 | 045 681 898

Sallon Depilimi Lumë's Details

lumescdetails

Mbrapa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Mirela Shasivari shpall të pavlefshme dëftesën e kl. Së dhjetë (10) të Gjimnazit "Ahmet Gashi" Prishtinë.

- Antifona Sheqiri shpall të pavlefshme dëftesën e kl. Së dhjetë (10) të Gjimnazit "Ahmet Gashi" Prishtinë.

- "Prime Group Constructione" shpall të pavlefshme certifikatën e TVSH-së, me nrb. 810046781.

- Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275

- Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanët me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139.

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm.

Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

- Lëshohet banesa me qira në qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.



ROYAL CROWN



ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

